

KULTURA ISLAME

ORGAN I KOMUNITETIT MUSLIMAN SHQIPTAR
E Përmuejshme Fetare, Filozofike, Letrare, Morale e Shqonore

PËRMBAJTJA:

1. Të ndershëm Lexuesë	Page 1
2. Përball së Vërtetës	" 11
3. Ç' vend zen Kurani në pikpamje legjislatoni	" 15
4. Njeriu i Vërtetë	" 20
5. Detyra e Grues	" 30
6. Hadixhe	" 33
7. H. Muhammedi dhe misioni i tij.	" 38

«Nuk të kemi dërgue veçse për me qënë mëshirë për gjithë gjinin njerzore.»
(K. kap. 21, vers. 107).

DREJTIMI:
KULTURA ISLAME
TIRANË

DREJTOR PËRGJEGJËS: S. BEGA
REDAKTOR: SH. PUTRA

„KULTURA ISLAME”

E PËRMUJSHME FETARO-KULTURALE

ZYRA E REVISTËS: NË QENDRËN E KOMUNITETIT MUSLIMAN
SHQIPTAR — TIRANË

P A J T I M E T

Pëmbrenda, një vit		Fr. ari 2.40
Përfjashta,	»	» 3.—
Për Studentë	»	» 2.—

Dorëshkrimet, të botuara ose jo, nuk këlbehen
Revista mban të drejtën e çdo ribotimi

PËRMBAJTJA E VITIT-I^ë TË REV. „KULTURA ISLAME“

(Prej 1 Shtatuer 1939 — 1 Shtatuer 1940-XVIII)

	Page
1. Të ndershëm Lexuesë	1
2. Për ball së Vërtetës	11
3. Ç' vend zen Kurani në pikpamje legjilasoni	15
4. Njeriu i Vërtetë	20
5. Detyra e Grues	30
6. Hadixhe	33
7. H. Muhammedi dhe Misioni i Tij	38
8. Mendime të ndryshme	41
9. Shërbimi Shoqëror	46
10. Zgjim' i meritueshëm	49
11. Njeri i Kohës	50
12. Kurani dhe letërsia	53
13. Ç' vend zen Kurani në pikpamje legjilasoni ?	58
14. H. Muhammedi dhe misioni i Tij	65
15. Durim' i Vërtetë	71
16. Në gjykatoren e Halifes Umer	74
17. Besimi (Vjershë)	76
18. Nji Konferencë	77
19. Të ndryshme	79
20. Islamizmi dhe Grueja	83
21. Ç' vend zen Kurani në pikpamje legjilasoni ?	87
22. Problemi fetar dhe Filozofia	92
23. Besnikija Shoqnore	98
24. Familja	107
25. Shqiptarizmi jashta dhe mbrenda Atdheut	110
26. Në gjykatoren e Halifes Umer	115
27. Jehu i Poezisë	117
28. Qarkore	118
29. Të ndryshme	122
30. Islamizmi dhe Gruaja	125

	Faqe
31. Islam! Kuptim' i kësaj fjale.	128
32. Islamizmi dhe qytetnimi	133
33. Problemi fetar dhe Filozofia	139
34. Mbi shpresën nden ndriçimin Islam	143
35. Fuqia e karakterit.	146
36. Shqiptarizmi jashta dhe mbrenda Atdheut	148
37. Dëshmorë të Kombit (vjershë)	153
38. Dashni Nane (vjershë)	154
39. Nji konferencë	155
40. Dil' e re (vjershë)	158
41. Të ndryshme	159
42. Islamizmi dhe Gruaja, një verejtje e Shkurtër] mbi të drejtat dhe detyrat e gruas]	161
43. Jeta.	163
44. Drita Islame	165
45. Ç' vend zen Kurani në pikpamje legjislacioni?	167
46. Realiteti i Fesë	172
47. Eurythmi	176
48. Shqiptarizmi jashta dhe mbrenda Atdheut	178
49. Festa e Sakrificës (Kurban Bajrami)	185
50. Në Botën e mendimeve	188
51. Xhamia e Qendrës Përmetit.	190
52. Sureja e Agimit (vjershë)	194
53. Në Gjykatoren e Halifes Umer	196
54. Një testament simbolik	200
55. Të ndryshme	202
56. Gjendja e djeshme dhe e sotshme e elementit] Shqiptar Mysliman në Shqipni]	203
57. Mendime të përgjithëshme të përditëshme	205
58. Islamizmi dhe qytetnimi	213
59. Mbi punën	216
60. Feja e zhvillimit	223
61. Kultura	228
62. Çampion i teknikës së re	231
63. Vullneti dhe njeriu Zheni	234
54. Ç' vend zen Kurani në pikpamje legjislacioni?	237
65. Islami dhe Fashizmi	243
66. Tragjedia e Qerbelasë.	154
67. Në Gjykatoren e Halifes Umer	257

	Faqe
68. Fleta artistike	261
69. Jemi kah mëngjezi i njizet Kallnuerit.	262
70. Organizata «Drita Hyjnore»	264
71. Përmbi mundimin e punën	266
72. Disa predikime	272
73. Shkrimi «Ibrahim Ljutvic»	279
74. Udhëheqësit e mendimit, Homeri	281
75. Të ndryshme	285
X 76. Halifi Umer, Komandanti Islam, Amer dhe Bi- blioteka e Aleksandrisë, Historjanët dhe Biblioteka]	287
77. Lindjes Profetike (vjershë)	297
78. (Lajmërim) Revista «Albania»	300
79. Taksa e detyrëshme (Zeqati)	301
80. Singeriteti	305
81. Xhamija e Pogradecit	306
82. Zotnimi i Vetëvehtes	307
83. Dy fjalë mbi të kaluemen. Pajtimi i gjaqeve 1876,	310
84. Edukata e Punës	315
85. Rindërtimi i Botës	319
86. Bamirës të njerzisë	323
87. Udhëheqësit e Mendimit, Homeri	324
88. Prindve të mij të perënduëm (vjershë)	326
89. Inagurimi i punimeve në Xhamin e Lushnjës .	327
90. Të ndryshme	328
91. Keq-kuptime të mëshehuna për mbrenda rrymës] Anti-Fetare]	331
92. Taksa e detyrëshme (Zeqati)	336
93. Jeta familjare, «martesa një muej gëzim edhe] gjithë jetën hidhërim»]	339
94. Aniversari i Lindjes së Profitit Islam	345
95. Një kërkesë me vend	348
96. Gënjeshtari dhe i Vërteti	349
97. E Shkuara, e sotëshmjia dhe e athmeja (vjershë)	351
98. Fjalë madhështore	355
99. Udhëheqësit e mendimit, Homeri	357
100. Shpirt mbëdhenjtë	361
101. Si u festua Mevludi në Kukës	362
102. Mbledhja e Këshillit të Përgjithshëm të Komu- nitetit Mysliman]	363

	Page
103. Të ndryshme	365
104. Taksa e detyrëshme (Zeqati)	367
105. Ç' vend zen Kurani në pikpamje legjislacioni	376
106. Islamizimi dhe përparimi	385
107. Revelacioni dhe shkenca	389
108. Rreth prodhimit Letrar Shqiptar	394
309. Vepër e re fetare me ndihmën e pop. Delvinës	399
110. Parajsi	403
111. Tue shfletzue Libra, «Para Zotit»	404
112. Jeta dhe teoria e sistemit Homocentral	405
113. Pozitivizëm e Romanticizëm	410
114. Drejtsia	412
115. Nji udhtim nga butrinto e në Tarabosh	415
116. Nga Kryesia e Komunitetit. Nji drejtsi me vend	420
117. Dashunija e flakt Hyjnore etj.	422
118. Reprezantim	424
119. Agimi Pranveruer i jetës Shqyptare (Dramë)	425
120. Islami, Përhapja e Qeverimi i tij, Rinija Mys.	431
121. Jeronim de Radës (Vjershë)	446
122. Përhapja e Islamizmit	448
123. Jeta dhe teoria e sistemit homocentral	455
124. Kur' ani dhe Umeri	458
125. Nji udhtim nga Butrinti e në Tarabosh	464
126. Në Selinë e Organizatës «Drita Hyjnore»	469
127. Probleme para problemesh	472
128. Letra Drejtoris Revistës	474
128. Të ndryshme	477
130. Agimi Pranveruer i jetës Shqyptare (Dramë)	479





Kultura Islame

Të ndershëm lexuesë!

SOT që kam fatin të drejtoj revistën Fetaro-Kulturale të Komunitetit Mysliman, dal para Z. s'uej, për t'ju ofruar opinionin tim mbi programin që do të ndjekim në këtë të Përkohëshme të ré.

Si i pa njohur, të thuash, me publikun Shqiptar, nuk mundemi të caktojmë vijat ekzakte, që do të ndiqen ndër këto shtylla, por me gjithë atë mund t'apim disa drejtime të përgjithëshme të programit që kemi parasysh.

Do përpiqemi, me sa të jetë e mundur, t'a pajosim popullin që përfaqsojmë me shpirtin e vërtetë të kulturës Islame. T'asaj kulture, e cila pajton me atë modernen përgjithësisht. Për t'ia arrirë cakt të parapam në program, revista do të pranojë artikuj letrarë, me ngjyrë fetaro-morale; artikuj kulturalë mbi sociologji, filozofi etj.

Planeti, mbi të cilin jetojmë, përmban edhe qindra milionë Myslimanë, të cilët, të gjithë së bashku, lidhen për një ideal të lartër, q'është t'u përhapë në mbarë botën toksore. Ideal ky që vlen t'i epet rëndësia e duhur, mbassi ay ka qëllim të mirën e përgjithëshme të racës njerëzore, e që simbolizohet në Personin e të Madhit të njerëzisë ashtu si përshkruhet ndër faqet e pastra të Librit të Shenjtë.

Tashti që po m'epet rasti të dirizhoj Organin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë së lirë, nën Qeverinë e Fashizmit, me anën e të cilit do mundohemi të trupëzojmë të vërtetat Islame nën udhëheqien e Përndritshme të Këshillit të Përhershëm të këtij

Komuniteti, i kryesuem prej Eminencës së Tij Dr. B. Shapati, i cili, me frymën e ré, përshtatun çdo kohe, dëshëroi edhe këtë herë t' i bëjë shërbimin e dukur Elementit që kryeson me vepra të gjalla. Për këtë, e falënderojme nga zemra Eminencën e Tij bashkë me Shokë, për sa kanë ndihmuarë e do të ndihmojnë për të mirën e përgjithëshme të këtij vendi nën hijen e dy flamurëve krahas.

E dij dhe e çmoj fare mirë se barra që m' u ngarkua është shumë e rëndë dhe delikate, dhe si i ri, ndofta mund të gaboja ndonjë herë, por do t' iu lutem qysh lashti, Lexuesve të ndershëm e sidomos kompetentëve të më korrigjojnë. Qëllimi i Komunitetit Mysliman është e mira e përgjithëshme e këtij populli; qëllim ky që ze një vend mjaft me rëndësi n' edukimin fetar, moral e shoqënor të kombit t' onë. Popujt fetarë e me morale të shëndosha janë destinue të rrojnë përgjithmonë, pse ata rinë lark nga gjithë të këqijat shkatërruese të njerzimit. Si shëmbëll të gjallë për këtë kini Fashizmin, ri-ngjallsin e Imperatorisë së Romës. Kjo e fundit dikur pat qënë shdukur; por sot që Shkël. e Tij, B. Mussolini, e forcoi Shtetin Italian në çdo pikpamje, dhe e bëri atë një Imperatori të çelniktë e të pa thyeshme prej myxyrave e gjâmave të shekullit. Tash çdo individ i saj ushqehet me një besim të pa tundur nën vijat e vueme prej Udhëheqsit të saj shembullor.

Tashti, le të kërthelemi në një pikë tjetër me rëndësi. Ne, drejtuesit e Revistës «Kultura Islame» do të mundohemi të pasojmë, kurdoherë, udhën më të mirë të dëshëruar prej të gjithëve. Artikujt me ngjyrë fetare, ata kulturorë dhe shoqënorë do të jenë të mirë pritun.

Drejtimi, është mjaft i lumtur dhe e ndijen për detyrë në këtë rast, t' i falet nderit, edhe një herë, P. T. Këshillit të Përhershëm të Komunitetit, që pati mirësinë të caktojë si bashkëpunorë dy intelektualë të zgjedhur nga pikpamja fetare e kulture, Z. Sherif Putra, Redaktor i Revistës dhe Z. Vexhhi Sulejmani Demiri, Profesor në Medrese të Përgjithëshme dhe ndihmës i përhershëm në pregatitjen e lëndës së Revistës.

Kujtoj dhe jam i bindur se ZZ. intelektualët, të pajosur me mësimë të larta edukative, morale, sociale, filozofike e fetare, nuk do kursejnë ndihmën e tyre bujare, qoftë edhe e vogël, për të mirën e dobisë e përgjithëshme të popullit t' onë, që është edukimi fetar-moral-kombëtar. Do t' u jem mirë-njohtës e falënderues

intelektualve e të rinjve që do të kontribuojnë duke dërguarë artikuj të rëndësishëm për t'u botuarë në revistë.

Qëllimi i Revistës. — Gjithë se cili mund t'a din se ligjet dhe parimet që udhëheqin njerzinë janë dy llojesh:

I. Parime të vëna prej shoqërisë që kryesohet prej disa personave të dalluëm prej të tjerëve, të cilët thirren zheni.

II. Parime ose ligje Hyjnore, komunikue Personave të zgjedhur nga çdo pikpamje fizike dhe shpirtnore.

Le te spjegohemi, në një mënyrë të shkurtër e për sa na premtojnë shtyllat e revistës, për sa i përket ligjëvet të shoqërisë njerëzore: thamë se, disa persona që ne në gjuhën moderne i quajmë zheni, tek këta reflektohen dhe pasqyrohen të gjitha ndjesinat, aktivitetet, besimet, imilitet, prirjet, mentalitetet, arsyetimet dhe gjykimet e një grupi njerzish, ose më mirë të një shoqërije njerëzore. Këto të gjitha shtrydhen e më së fundi trupëzohen në ligje e në institusione që më vonë bëhen themele të shoqërisë e marrin emnin ligje të përgjithëshme. Këto nuk janë ligje të vëna prej individualëve, tue i konsiderue këta një nga një, as që janë bashkimi në formë të një serie të përbërë prej ligjesh, të vëna njëri pranë tjetrit; por, janë reflektimi i të gjitha prirjeve ndjesinave, zakoneve, kuptimeve e mentaliteteve të ndryshme, të mbrujtura në shoqëri (të përbërë prej individualësh) dhe mandej të trupëzuara te një person i vetëm, i cili mbassi t'i ketë bluarë mirë, kthehet e ia transmeton shoqërisë, i së cilës ay është pris. Dhe këto mandej marrin formën e ligjit ose t'institucionit. Janë ligje të përgjithëshme dhe quhen ligje shoqnore, të cilavet individuali detyrohet ose shtrëngohet t'iu bindet.

Një shëmbëll fare e vogël dhe elementare, për çka u tha sipër, gjendet në shkencën fizike. Kujtoj se, se i cilit shkollor i bje ndër mend se si profesori i fizikës i spjegonte mënyrën e formimit t'ujit? Formula është, në dukje, mjaft e thjeshtë. Ajo përbëhet prej bashkimit t'oksigenit me hidrogjenin, mund të thotë ndokush. Shumë mirë, po a thua se uji është vetë oksigjeni, ose a thua se është vetë hidrogjeni? Jo. Dhe në mos a është bashkimi i oksigenit me hidrogjenin tue marrë formën e një serie? Jo. Po çka është mëshehtësia e këtij bashkimi? Përgjegja është mjaft e thjeshtë: është ajo cilësi që ne e quajmë ujë.

Ligjet e vëna prej shoqërisë mandej marrin formën e një determinizmi. Çdo individual, pjestar i shoqërisë, duhet t'iu

bindet, për ndryshe dënohet. Me këtë mjafton për sa i përket ligjëve të shoqërisë, çdo formë që të ketë kjo e fundit.

Tashti le të çekim edhe një lloj ligjesh të tjera: Ligjet Hyjnore. Kur Zoti i Madhnueshëm konstaton se një popull ka nevojë për përkrahjen e Tij, ose me terma të tjera, kur shihet se ky popull është zhytur në pellgun e vesit, atëherë sa arrin në një gradë që mund të mohojë edhe Njitimin e Zotit, në atë kohë Ay zgjedhë një nga njerzit e mirë, i plotësuarë dhe i pajosur me të gjitha cilsirat e dukura, dhe nëpërmjet të disa fuqive i zbulon atij disa urdhna veprimi e ndalimi. Këto Ia dhuron Zoti këtij personi, mbassi t' a ketë urdhëruar më parë me Besim. Pra Zoti i jep të tillë njerëzve të zgjedhur, besime dhe veprime, në bazë të të cilave, njeriu lypset të punojë. Kjo punë kryhet me anë revelate dhe inspirimi. Edhe këto farë urdhërash, mbassi t' i aplikohen njerzisë, marrin, prap se prap, emrin e ligjit dhe t' institucionit. Këto lloj ligjesh iu patën dhënë Profitit të Math, H. Muhammedit, si edhe profitëve që erdhën para tij. Parimi i Njitimit që iu zbulua H. Muhammedit (A. S.), robit të Zotit e të Dërguarit të Tij, është i pa tundur nga çdo Kohë e Klimë dhe do të mbetet i tillë deri në pa mbarim.

Parimi i përmendur do t' u-kuptonte më mirë, sikur t' i hidhshim një sy të shpejtë historisë botnore përgjithsisht e veçanërisht asaj Islame. Do të pyetshim: çka ishte Siujdheza Arabike para Dërgesës së Muhammedit? Ç' ka u bë në periodën që rronte i Dërguemi dhe çka ndodhi gjatë qindvjetorësh, d. m. th. mbas ndërrimit jetë të tij?

Siujdheza Arabike, para Dërgesës, ishte mbytur në pellgun e veseve të mbrapshta! Nuk kishte as institusione të drejta. Për t' a rregulluarë këtë popull u-deshte një person i plotsuarë dhe i aftë për të pranuarë parimin e Njitimit, duke gremisur e shkatruarë idhujtarinë, që s' mund t' a bindële gjykimin e arsyes e e njeriut. Ay, e përmbysi idhujtarin që Arabët pasojshin verbërisht, një herë e përgjithmonë.

Vendi, ku lindi H. Muhammedi (a. s.), mjafton që të tërheqë vrejshjen, kurrështinë dhe zemrat, e shkrimtarëve, vjershëtorëve, historianëve dhe dijetarëve të ndryshëm, të cilët t' inspiruarë prej tij, duhesh të merrshin qëndrimin më pozitiv e më serioz, për t' a studjuarë nga çdo pikpamje. Ay mësheh në gjiret e tij një trashëgimi që nuk shterohet as një herë. Kjo trashëgimi mbeti dhe do të mbetet gjithmonë virgjinë. Ajo, pat

ardhë në marrëdhënie me të gjitha anët e botës në të gjitha epokat historike. Mos studimi i thellë e i drejtë i këtij vendi, si dhe i ambjentit të tij, që bërë shkak që letrarët, vjershëtorët dhe eksploratorët të gjejnë pengime ndër zbulimet e thesarëve të vërtetë të kësaj trashëgimije. Një shkak tjetër ishte edhe se eksploratorët Muslimanë e konsideronin si një vend të shenjtë shpirtnor dhe prandaj nuk u-thelluanë në studimin e tij. Gjithashtu edhe jo-Myslimanët u-përpoqën që të njeriën në shesh shumë prej mistereve të tij, por s'ia arritën qëllimit si duhet po për të njëjtin shkak të shenjtëris. Kështu vendi i Profitit ndër kohët e fundit kaloi një jetë decadence. Kjo s'është gjë tjetër veçse një problem e ndërlikuar që duhet zgjidhë. Njerzit, kurdoherë, largohen nga çdo gjë që duket si ë vishkur, me gjithëse ajo të përfshijë në gjirin e saj sendet më të çmueshme.

Çdo gjë që u-shkrua për mbi Profetin e Islamit në këto kohët e fundit, pat një vlefte shkencore shumë t'imitë, tue mos qënë e aftë për të zbuluarë të vërtetën e këtij vendi dhe psehin që e Thëna (Kaderi) e pat zgjedhur për Qendër Revelate dhe Dërgesa në mënyrë që të munda të bindi mejtimin e këtij shekulli. Gjithë çka patën shkruarë dijetarët e huajë për 'të, ishte fare pak e pajtueshme në mos e kundërshtueshme me përmbajtjen e Fenomenit Shpirtnuer. Fenomen ky që ndryshoi fytyrën e historisë për katërmëdhjetë qindvjetorë me radhë. Fenomen që do të vazhdojë të jetë veprues me një përshtypje të pa vdekur mbi jetën e njerzimit mbarë, mbassi Fuqija Shpirtnore, gjithmonë është e dëjë dhe e pajosur me një të tillë përshtypje dhe pushtet që munden t'orientojnë gjithë botën.

Për të mundur me kuptue mirë se ç'ka është feja Islame, do të na duhet të dijmë këto katër baza: 1) Kuranin; 2) Tradisionin Profetik; 3) Bashkimin e Dijetarëve Mysliman për të vënë një dispozitë — për të spjegue atë ç'ka nuk është e qartë në Kuran; — 4) Methodën e Juristëve.

Gjithashtu për të kuptuarë më mirë se çka është thënë për Islamin dhe Prijsin e tij, në se është një fé e vërtetë që i përshtatet çdo vëndi e kohe, do të na duheshte një studim i gjatë i të gjitha veprave të shkruara në qindvjetorët e parë t'Islamit, tue shtue edhe të vërtetat, që u shkruen në kohët e fundit si edhe ato që u thanë mbi Islamin e Prijsin e tij prej dijetarëve, udhëtarëve e zbuluesve të ndryshëm Oksidentalë. Po t'i kritikojmë këto të gjitha, tue dallue të vërtetën

prej të shtrembtës — mbasi kjo e fundit mund të ketë hyrë n' Islam prej Konditave të ndryshme shoqnore dhe politike — rezultati do të jetë shumë a pak i mirë.

Është e domosdoshme që njeriu, për sa të jetë e mundur, t'i diskutojë këto të vërteta me një ndërgjegjë të pastër e me një logjikë të qartë. Dhe këtë për të mirën e përgjithëshme. Në këtë diskutim e investigasion del shpesh herë në shesh përshtypja e opinioneve të ndryshme. Gjë që duhet të mjekohet. Ndryshim mendimesh ndodhin, dhe janë krejt gjëra të zakonëshme, ndër pasuesit e çdo feje dhe në çdo epokë. Këtu del, vetvetiu, pyetja: Në se ndryshimi i mendimeve dhe konflikti në mes t' opinioneve të ndryshme shkaktojnë mos bashkëpunimin ndër pasuesit e fesë Islame, dhe në se substanca e sajë është e njëjtë ndër dy a më shumë dogma?

Përgjegjja është se të gjitha këto dogma kanë për substancë të tyre Njitimin. «Thuej O Muhammed! Që Ay, Zoti, është Një i pa shoq, Zotit i mbështetet çdo gjë q'ekziston, Ay as që është Lindës, as i lindur, as që mund t'i përgjasë kurrkush» (S. Ihlas).

Libri i Zotit është dërgue për të gjithë. Lutja e jonë është që Myslimanët të ndihmojnë në përmirësimin e doktrinave dhe të motto-ve të tyre. Por, gjërat q' i përkasin përmirësimit evolucionojnë a shvillohen, si mbas ngjyrës së tyre, tue u mbështet në ç' ka lypin nevojat e kohës. Neve rrojmë në një kohë në të cilën sendet ndryshojnë me një shpejtësi vetëtime, në mënyrë që çdo gjë q' u konsideronte e mirë, e përmirsueme dhe e nevojshme në të djeshmen, konsiderohet e vjetrueme në të sotmen, për arsye se gjërat që mund të çpiken e të zbulohen sot mund të jenë më të mira dhe më të afërta për dobinë dhe frytin e kërkuarë.

Shpesh herë mund t' i drejtohem i edhe kritikës për sa i përket ndonjë dogme që duket si e pa aplikuarë. Këtë do t' a bëjme vetem atëhere kur të jemi të bindur plotsisht se kritika mund të na çojë në të vërtetën. Kritika është çelësi i përmirësimit, sepse, si dihet, tue investigate shkaqet që e çojnë në një të vërtetë fetare në dekadencë, nuk jemi tue bërë tjetër veçse me personifikue sëmundjen, që kështu të na lehtësohet të gjeturit e barit për t' a mjekue.

Në çdo çeshtje, për t' u zgjidhur, do të kemi si bazë Kuranin dhe jetën e Profitit, të cilët janë dy simbole kryesore.

Në Kuran dhe në jetën e Profetit do të kërkojmë shëmbëll, mësim dhe drejtim. Kurani dhe jeta e Profetit Muhammed, plot-suesit të profitëve e të dërguemëve, janë të mjafta për çka u tha më lartë.

Për sa i përket mendimit t'onë në çdo çeshtje do të marrim parasysh edhe logjikën me methodën e re shkencore. Nuk është mirë për me ia kushtue mbështetjen besimit të trashëguem, për pa e provue dhe ekzaminue këtë gjer sa t'arrihet për t'u-bindur dhe për t'u-besuarë se është i vërtetë, e mbrenda arsyes e ndërgjegjes së pastër. Do t'ishte i mangët ay që ushtron ndonjë doktrinë vetëm për të vetmen arsye se atë e ushtrojshin dhe e besojshin prindërit e tij si të vërtetë e të pa dyshimtë. Përkundrazi, shifet e domosdoshme për njerinë, për të vetmin shkak të prestigjit dhe të bujarisë së tij njerzore, të derdhi mundin e duhur, e të kuptojë çka i flitet: qoftë doktrinë, legjislaturë, shkencë ose art. Po mundi të drejtohet në këtë mënyrë, përfundimi është i dobishëm. Për ndryshe le t'a kërkojë të vërtetën e të drejtën prej atyre që kanë njohuni mbi 'të.

Dijetar' i aftë është ay që mund t'a bindi ndëgjuesin, për sa i përket së vërtetës, të cilën ka mundur t'a arrijë me anë shoshitje e argumentimi. Shoshitja dhe argumentimi duhet të bëhen me mënyra të mira e të bukura. Në fé s'ka gjë të shtrëngueshme. Zihja dhe diskutimi do të jenë të kota n'atë kohë që e vërteta është dallue prej të shtrembrës. Ngul këmbë këtu, d. m. th. në të shtrembrën, vetëm ay, të cilin pasioni i tij e errëson dhe i a humbet drejtimin.

Qëllimi më i lartër i Islamit s'është tjetër veçse m'e ba njerinë të pasojë atë çka gjuha filozofike e quanë Idealin më të lartër (Elmethelul 'Aalà), ose atë çka gjuha Ethike e thërret «summun bonum» (e mira e përsosun). Njeriu tue derdhë gjithë përpjekjen e tij, duhet të konsakrojë jetën e vet për t'ia arrirë idealit më të lartë, kundrejt të cilit, ay orienton të gjitha përpjekjet e tija, tue e arrirë ose tue dhënë jetën për 'të. Kjo shprehje na ep me kuptue mjaftë drejt qëllimit ose fundit të kërkuem.

Mirë po, ç'ka është ideali më i lartë n' Islam? Përgjegjja është: të kënaqurit Zotin, të bërët punëra të drejta, të drojturit Zotin, të dëshëruarit për vëllanë t'ënd atë çka ti dëshëron për vehte. Le të përfytyrohen këto kuptime shpirtnore, tue i u

dhënë një formë landore. Konsiderojë këtë formë landore si idealin më të lartë, për të cilin ke konsakruarë të gjitha përpjekjet e jetës s'ënde. Ky përfytyrim është shumë i rëndësishëm.

T'a zëmë për shëmbëll se ndonjëri dëshëron të pasurohet dhe këtë veprim e konsideron si idealin më të math të tij. Mirë! Por, është e domosdoshme që të fitohet së pari konendimi i Allahut tue qënë pios, i drejtë dhe i ndrojtur, tue mos i përdorë njerzit, kur ti don të bëhesh i pasur, veçse me atë mënyrë që të përdor ty no një prej tyre, i cili çfaq vullnetin t'arrijë të njëjtin Fund ose Qëllim.

Një shëmbëll tjetër q' i ngjanë së parës është edhe kjo: po të jetë se ndonjë dëshëron t'arrijë në fuqi, le të derdhi të gjithë mundin për këtë. Mirë! Por, këtij i duhet që për t'arritë në këtë fuqi, të fitojë konendimin e Allahut, të jetë i drejtë dhe i mprojtur, të mos e përdorë tjetër kënd veçse n'atë mënyrë q' është e domosdoshme që ky tjetri t'a përdorë atë, kur ky tjetri të marrë po atë fuqi ose pozitë.

Pra, po të dojë njeriu t'ia arrijë idealit që ven parasysh, është e domosdoshme t' i kushtojë atij gjithë përpjekjet e veta, tue ba çdo sakrificë. Çdo gjë e urrejtshme që t' i takojë njeriut idealist, nuk është kundër tij, mbassi dëshira është vetëm e vetëm me fitue kënaqësinë e Zotit. Ky person i tillë do të konsiderohet i drejtë, i divotshëm, i ndrojtur prej frikës së Zotit. Ky beson kurdoherë në vllazërimin njerzuer, tue dëshëruarë për vëllazërit e tij, atë çka dëshëron për vehten e vet, tue shpresue për 'ta mirësi, tue kërkue që çdo njeri të fitojë idealin më të lartë, atë ideal që edhe ay vetë e kërkonte dhe e konsideronte si qëllimin kryesor të tij.

Por idealet e lartra ndryshojnë shumë njeni prej tjetrit. Më i larti ndër 'ta është ay me të cilin Perëndija dërgoi Profitin e Tij: Udhë e Vërtetë dhe Dritë për njerëzit.

Ky ideal, në periodën e parë t' Islamit u-konsideronte si qëllimi kryesor i jetës. Të gjitha qëllimet e tjera i shtroheshin këtij. Të sakrifikuarit për triumfin e tij u-shpresonte prej kujtdo. Prej kësaj kuptohet se që të gjithë, mjeshtri, tregtari, bujku, etj., çdo përpjekje që bënin, e bënin për 'të. Merr për shëmbëll tregtarin: ky do t'ia epte një pjesë të fitimit të vet nevojtarve dhe të mjerëve. Ata shpesh herë sakrifikojshin edhe jetën n' Udhën e mbarë t' Allahut. Feja Islame i mëson popullit ashtu edhe individualëve prej të cilëvevet përbëhet po-

pulli, se është i domosdoshëm për shoqërinë një ideal i lartër. Besnikët janë një popull i vetëm dhe i pa ndarë, çdo njëri i detyrohet tjetrit si i detyrohet vëllaj vëllajt. Ky veprim është vetëm e vetëm për triumf të së vërtetës e të drejtësisë. Duhet pra që të ndjekim të njëjtën udhë të Zotit, t'a duamë njëri tjetrin, të kërkojmë ndriçim prej dritës së Zotit. Me këtë parim të tillë i mësohet njerëzve vëllazërimi nën Kryesinë e Një Zotit të vetëm i Cili e din çdo gjë, qoftë edhe sasija e një grimce fare e vogël e qiellrave dhe e tokës. Një Zot i këtillë i shtyn njerzit drejt përplotsimit. Dhe në të vërtetë këtij përplotsimi i arrihet vetëm atëhere kur t'i shtrohem ligjëve dhe parimeve të Zotit. Në qoftë se ndonjë ngrën krye kundra urdhrave të Zotit, ay përbuzet prej shoqërisë njerëzore, dhe fiton një mëkat të math kundrejt urdhërave Hyjnore.

Këto idera të lartra janë mësimet që na pruri Profiti i Islamit. Përshtypja e këtyre mësimëve ishte shumë e madhe: si n'epokën Profetike ashtu edhe mbas saj. Ngadhnimi në kohën e Ebu Beqrit dhe Ymerit kapërdiu Persinë dhe Bizantin, tue u shtrirë më vonë edhe përtej këtyre të dyjave, si në Lindje ashtu edhe në Perëndim. Kjo gjë vashdoj kështu gjersa përparimi Islam arrijti në më pak se një qind vjet, atë që nuk e pat arrirë ndonjë përparim tjetër për qindra-vjetorë me radhë. Kudo që shtrihej ngadhnimi, u-dëgjonte fjala e madhe: «S'ka Zot tjetër veç Allahut, Muhammedi është i Dërguari i Tij = (Là ilâhe il-lâh, Muhammedun Resulullah).

Kjo, ishte perioda e artë për Islamin. Zoti i u pat çelë Myslimanve dyert e mirësinave, me gjithse këta kujtuanë se kjo periodë nuk mbarohej kurrë dhe kujtuanë se do të nuhatnin përherë aromën e bukur të trëndafilut, ata, djemtë e stërniprit e tyre, gjersa Zoti t'a trashëgonte tokën bashkë me gjërat q'ekzistojnë mbi të. Nuk i shkonte ndërmend askuj mbassi ishin të rrethuarë prej mirsirave, se dhe koha ka radhën e historinë e vet, çdo e sotshme ndiqet prej të nesërmes dhe Zoti e ndryshon të mirën e ndonjë kombi kur ata e ndryshojnë vetë.

Po t'i u mbahet njeriu pik për pikë parimeve Islame e po të veprojë mbrenda kufive të tyre do të gëzojë jetën dyfishë, për sa i përket lumtërisë: jetën materiale dhe atë shpirtnore. Nga parimet e pa lujtëshme të tij, Islami vrapoj me hapa më të shpejta e të sigurta tue ndriçuarë botën mbarë,

me një përparim të ri, mirësitë e të cilit njerzija vazhdon t'i shijojë në çdo kohë evolucioni. Islami i a ruejti botës mbarë e sidomos asaj të sozmes të mirat e mejtimit njerzuer: të mendimit Grek, Hindian dhe Persian. Pra, a nuk ishte Islami ky që na çoi në pregatitjen e të gjitha mirsinave të përparimit modern? Pse pra t'akuzohet Islami që gjoja është shkak dekadence e mbrapshtimi për bijt e tij e t'atyre që ushtrojnë?!

Tashti për tashti do të mjaftojmë t'a çekim shumë pak këtë fenomen, për të qartësuarë se dekadencia e popujve Myslimanë i kthehet shkaqeve politike e shoqërore. Nuk i referohet as pak përshtypjes së dogmës ose së fesë. Dhe se dogma, besimi dhe feja, nga ana e tyre, edhe këto patën qënë influencuarë, sikurse Arabët veçanërisht dhe popujt e tjerë Mysliman përgjithsisht po prej atyre shkaqeve. Prandaj, është shumë lehtë për Myslimanët të kapen prapë për origjinën e fesë së tyre; e për këtë iu mjafton të heqën dorë prej gjërave që s'pajtojnë me Ligjet Hyjnore; t'a hedhim poshtë vesin e të keqen e t'i zëvendësojnë ato me virtutin e të mirën.

Nuk desha të bëj një studim të gjërë mbi Historinë Islame, por i hodha një vështrim shumë të shpejtë e përfaqe, me qëllim që t'iu tregojmë Lexuesve të ndershëm vijat e përgjithëshme që do të ndjekë Revista e jonë. Revista e jonë do të ketë gjithmonë përparim të shkojë mbrenda vijave të Drejtuesit të Math, H. Muhammedit, në pikpamje morale, intelektuale, shoqnore e fetare. Gjithashtu do të ketë për princip të pasojë gjurmët e shokëve të Tij të Mëdhenj, tue mos i bërë vend mendimeve dhe kritikave t'errëta. Do të mundohemi të qartsojmë çdo gjë që të jetë për të mirën e përgjithëshme e sidomos t'elementit Mysliman. Ka për qëllim bashkë-punimin në mes të njerëzve, që t'a ndihmojnë njëri tjetrin të kryejnë vepra të mira e të dobishme.

Prijsa t'onë në këtë gjë do të jenë kurdoherë Kurani dhe jeta e Profitit. Nuk do na shkojë kurrë ndër mend që të cënojmë fenat e profitërve që kanë ardhur para H. Muhammedit. Këta profitër edhe vetë Kurani Qerimi i ka njohtur, e do të jenë të pastër nga çdo kritikë e pa vend që ndokush do të guxojë t'iu bëjë.

Mejtimet dhe gjykimet t'ona do të kenë kurdoherë për themel, bazat Islame, tue i krahasuarë këto me të mirat e këtij qytetrimi të rij. Me gjithkëtë nuk do t'a lemë mbas dore edhe gjykimin mendor t'onin, tue u-mbështetë në ndërgjegjen e pastër. Do të themi kurdoherë të vërtetën, tue dijtur se me anën e saj mund të fitohet Kënaqësija e Zotit dhe Shpërblimi i plotë i Tij.

DREJTIMI

PËRBALL SË VËRTETËS

PO t'a kqyrim me verejtje rruzullimin, gjejmë se çdo gjë në 'të është tue shkue kah përparimi. Çdo gjë në fillim duket të zotnojë disa cilsina trashiguese, të cilat presin kohën dhe rastin për me dhënë frutin e duhun. Përparim e jo çpërparim, marshim e jo ndalim është urdhni i ditës në natyrë. Shkurt çdo hap në natyrë shkon para e më përpara. Çdo gjë ka një rrugë të caktueme, të cilën e ndjekë pa iu-shman-gun as pak dhe e bân që fakultetet e heshtuna të saj të bâhen realitet. Kështu ndigjesa e bindja kundrejt ligjit duket të sundojë përqark nesh e të ruhet me kujdes të math nga çdo atom në natyrë. Të gjitha manifestimet e ndryshme të natyrës mvaren në zbatimin e plotë të ligjit, e këtë vetëm për krijimin, ekzistencën, shvillimin dhe frytzimimin e tyne. Jo vetëm me kaqë por edhe relacionet plotsuese, reciproke që sendet e ndryshme kanë në natyrë si dhe shërbimet që i sjellin njani tjetrit, janë vetëm e vetëm prodhimi i përljes që i bâhet nga manifestacionet e natyrës, Ligjve të Hyut, d. m. th. Ligjve të natyrës. Kjo është e vërteta. Po në të tilla terma Kurani, Libri i Islamizmit, e përkufizon atë: «A kërkojnë populli fé tjetër përveç asaj të Zotit? A nuk shohin ata se krejt natyra përqark tyne — çdo gjë që është në qiellna e tokë — i përulet Zotit vetëm për ekzistencën e vetë?» (Kapt. 2, vers. 136).

Me fjalët e sipërme Kurani na ep fenë natyrale. Pra, a nuk është njeriu një pjesë e të njëjtës natyrë, një atom i fuqishëm, sikur e ka quejtë njani, produkti më i mirë i natyrës, vepra më e përsosun e Zotit?! Kurse kështu, a është e mundun që ai të jetë i pa fé? Me qëndrue në një pozitë t' atillë kish për të rá në kundërshtim me vetë perbâmësit e natyrës së vet, pse çdo atom i natyrës bân pjesë në trupin e njeriut. Trupi i njeriut është universi i zvogëluem — një mikrokozëm — në termën shkencore. Çdo organ në 'te ndjekë fenë e ligjit dhe të ndigjesës vetëm për ekzistencën e vehtes së vet. Me fjalë të tjera, çdo organ kryen detyrën e tij që i përket nën bindje të plotë kundrejt disa ligjëve të nguluna. Minutin që ai dështon

të veprojë n'atë mënyrë, i vjen dhimbje serioze ose dâm i math a vdekje. Prandaj njeriu nuk mundet, si një tânësi, të ketë rrugë tjetër përveç asaj që ndiqet nga përbâmësit e ndryshëm të trupit e të natyrës së ti. Feja për me i shërbye njeriut duhet me qenë në pajtim me natyrën e tij, dhe për këtë Kurani thotë, — «Natyra dhânë nga Allahu — është natyra mbas së cilës njeriu ka marrë formën e vet — kjo është feja e vërtetë» (30:30). Kështu Kurani na ep fenë t'onë të Ligjit e të ndigjesës; besimin e të përulunit ligjve të Hyut me qëllim për me shvillue natyrën t'onë.

Qëllimi i fesë. — Kjo na çon ke një fazë tjetër e subjektivit. Ç'ka është atëhere qëllimi i fesë? Kurani e formulon atë me fjalët që vijnë: «Ata që ndjekin revelatat nga Zoti, (d. m. th. feja dhânun atyne prej Zotit), janë në rrugën e shpëtueme, që u ka ardhë nga Krijuesi, Ushqyesi dhe Rritësi i tyre; dhe ata do të jenë fitues, për shkak të vetë-shvillimit të tyre» (2:5). Fjala «sukses» përmendun sipër në tekst është «*felah*», e cila, me gjithëse, në gjuhën popullore don të thotë «sukses», por literalisht ka kuptim të shvillimit. Si çdo gjë në natyrë edhe na kemi fakultete të ndryshme që flejnë tek ne. Në se një lis gjigantik është mësuh në një send aqë të vogël sa lenda, në se pema e arës, e lajthisë ose çdo peme tjetër e madhe me gjithë degët, gjethet, lulet dhe frutet e tyre mund t'u sivolgëkan nër sasina aqë të konsiderueshme nër farat e tyre respektive, atëhere sillni ndër mend se janë mijra sende të mësuhuna në strukturën e njeriut. Kur një pikë gjak¹⁾ shvillohet në një trup njeriu të bukur në botën fizike, a nuk duhet ai, gjithashtu, të zotnojë gjana me bukuri të posatshme për t'i shvillue edhe në botën mendore, morale dhe shpirtnore? Në qoftë se rritja fizike ose lëndore del nga fara, kjo vjen vetëm nga shkak i të rrejtunit të disa ligjëve të pa-ndryshueshëm; pastaj rritja morale, mendore dhe shpirtnore presin gjithashtu manifestimin e tyre kur fakultetet njerzore veprojnë nën të njëjta ligje. Për me dhânë ligje kësodore është detyra e fesë, pse qëllimi i kësaj së fundit është të pajosë njerin me një kodë jete, me të cilin ai të mund të sjellë vetë-shvillimin e të gjitha zotsive të mëshefta që kërkojnë të realizohen; dhe në

1) Revelata e parë që muerr profeti Muhammed nga Zoti i referohet madhënis që e pret çdo njeri që ndjek revelatën Hyjnore të Kuranit, dhe se një pikë gjak nër konditat e tij embrionike përmban: «Këndo me emnin e Zotit t'and që të krijoi. Ai krijoi njerin nga një pikë. Këndo se Zoti t'and është më i ndershmi, i cili iu mësoi të shkrueni me pendë, i mesoi njeriut atë çka s' dinte» (Kap.80).

këtë pikpamje, Theozofia e Spiritualizma ndjekin Islamizmin.

Vendi i fesë. — Kujt duhet me iu dhënë kjo fé dhe në ç' rast? Një pyetje aqë e thjeshtë për t'iu-përgjegjë, por as një herë nuk i është dhënë përgjegje korrekte. Feja ardhun nga Zoti për naltsimin e njerzimit, duhet t' i epet çdo njeriu në çdo vend e kudo qoftë ai. Zoti i të gjithë kombeve dhe racave, a ka qënë i anshëm kë ndonjë racë ose komunitet, për sa i përket plotsimit të nevojave fizike? Djelli, hâna, yjtë, retë, shiu dhe gjithë funksinet e tjera të natyrës, ekzistenca e veprimi i të cilave është i domosdoshëm për rritjen e njerzimit, nuk i janë mohue as një antari të tij (njerzimit). Pra, kur Zoti uuk ka bâ dallim në mes të një njeriu e të një tjetri, as nuk ka bâ kurrëfarë difference në mes të një race e të një tjetre nër dhurata t' fizike, si mundet që Ai të veprojë ndryshe nër gjânat shpirtnore? Ai duhet më i dhënë fenë çdo populli pa-dallim race ose ngjyre. Premiset dhe parimet kanë qënë të qarta dhe logjika e thjeshtë, por askush para ardhjes s' Islamizmit nuk i është përgjegjë së vërtetës. Çdo komb, me gjithse pretandon inspiratë Hyjnore për origjinën e besimit të vet, pra nuk njeh që të njajta privilegje t' i jenë dhënë ndonjë feje tjerër mbi sipërfaqen e tokës. Ata vetëm fenat e veta i quejnë si t' ardhuna drejt nga Zoti. Mendja e tyne e shkurtë krijoi fanatizëm, urrejtje dhe mos-armoni. Ata shkaktuen që fabrika e vllaznimit të përgjithshëm të prishet, që duhesh t' ishte e themelue në kryesin e Zotit. Kondita të tilla vijuen për deri sa u-zbulue Kurani, i cili nër fjalët e para të kaptinës fillestare, e çrrënjosi atë mentalitet të gabuem kur deklaroi: «*El-hamdu lil-lahi Rabbil-Alemijn*» — gjithë madhënia dhe lavdimet janë posaçërisht për Allahun, Krijues, Ushqyes dhe Shvillues, jo vetëm i një populli, por barazisht i të tănë racave, komuniteteve dhe kreatrave. Prap Libri thotë: «S' ka as një komb mbi sipërfaqen e tokës që të mos i ketë ardhë një Parlajmues nga Zoti» (35:25). «Çdo racë ka pasë Lajmëtarin e vet; çdo popull Udhëheqsin e tij», (13:7). Kështu pra, fjala e fundit prej Zotit i dha origjinë Hyjnore çdo feje që ekzistonte deri atëhere nër pjesë të ndryshme të botës. Zoti i Kuranit ose Islamit nuk është Zot i një fisi ose kombi, por Zot i tănë racave, komuniteteve dhe kombeve. Prandaj Muslimani beson ose është i detyruem të besojë, në dërgimin nga Hyu i çdo Profeti të math, në çdo krahinë qoftë — në Çinë, Hindi, Persi, Paletinë, Egjipt, Europë

ose Amerikë. E, për këtë due të përmend vetëm fjalët e Kuranit që vërtetojnë thanjet e mäsipërme «Ju (Muslimanë) i tregoni botës tue thënë: na besojmë në Zotin, n' atë çka i është zbulue Ibrahimit, Ismailit, Is-hakut, Jakubit dhe Fiseve; na pranojmë çka i është dhënë Musajt, Isajt dhe Profetëve të tjerë të botës. *Na në as një pikpamje nuk i dallojmë disa Profetë prej të tjerëve.* Na i përulemi vetëm Allahut, (2:136). *Na jemi adhuresit e Zotit e jo të profetëve.* Respektin atyne ua bëmë vetëm pse ata na prunë fjalë nga Zoti. S' ka gajle se kush ka qënë. Në se unë, si Musliman, marr vesht se aksecili njeri ka qënë lajmëtar i emnuem nga Zoti, para se vjen i Bekuemi i fundit i Racës njerzore, ai është Profeti i em dhe fjalët e tija, n' origjinalin e tyne të thjeshtë, janë libri i em i vërtetë. Vetëm këto mund të jenë principet themelore të vllaznimit të përgjithshëm të njeriut. Ky është, gjithëashtu, objekti dhe qëllimi i Theozofisë dhe Spiritualizmit. Mbasi pandehmat s' janë realitete, qëllimit nuk mund t' i arrihet për pa pasë disa principe ose parime për me na udhëheq hapat drejt qëllimit t' onë të fundit. Feja sjellë bashkimin dhe keq-përdorimi i saj sjellë përçarjen, dhe unë kam dështue të shoh se si disa predikues mund të sjellin, një vllaznim të përgjithshëm për pa marrë parasysh edhe besimet fetare t' antareve të fenave të tjera. Hapat për sa i përket taktikës së përdorun pa-dyshim krijon flohtësi, por mbas së gjithash, vetëm feja Islame ka mundun të dalë me sukses në pajtimin e elementeve të kundërshtueshme dhe t' i bájë ata një tănësi armonike tue mos i u prekë nër të drejtat e tyne. Islami erdhi për me zbërthye problemin e mäsipërm, me vllaznue krejt botën. Me pranue origjinën Hyjnore të çdo feje, në thjeshtsinë e saj, është si me i dhënë fund gjysmës së grindjes fetare, dhe me pranue profetnit e të tjerëve sikur t' uejin, është si me e shtroue edhe një të katërtën e rugës drejt bashkimit, dhe mbetja nuk mund të shkaktojë no një shqetsim. Një gjë e tillë kish për t' a sjellë botën në një marrëveshtje mäs të mirë, në qoftë se edhe predikuesit e fenave të ndryshme do të vepronin si mbas këtij rregulli t' artë kur t' u predikonin të tjerëve të vërtetat e tyne.

SH. PUTRA

Ç' vend zen Kurani në pikpamje Legjislacioni?

Eshtë pyetja që na bëhet me anë të një letrës të dërgueme prej Z. R. B. Mbassi pyetja është shumë delikate dhe e rëndësishme, do të ishte një gjë krejt e pa mjaftueshme, po t' i jepshim spjegime dhe shkoqitje me një artikull të vetëm Zotnis si edhe kujtdo që mund të interesohet. Drejtori i revistës vendosi të shkruaj një seri artikujsh të shkurtër përmbi 'të, për sa t' i premtojë vendi i revistës. Dhe ja këtu më poshtë po fillon përgjegjja.

Ç' VEND ZEN KUR' ANI NË PIKPAMJE LEGJISLACIONI?

PËR t' i dhënë një përgjigje të saktë dhe të mjaftueshme pyetjes së sipërmendur, duhet t' i hedhim një vërrejtje të përgjithshme e të shkurtër Kulturës Islame.

Kultura islame përmbledh shumë anë: disa prej tyre flasin për Letërsinë dhe Gjuhën; të tjerat kanë lidhje të ngushtë me intelektin, mejtimin, gjykimin dhe arësyetimin. Me terma të tjera, ajo, në tansin e saj, kthehet në dy burime kryesore: I. Kuptimi; II. Kallëpi që merr ky kuptim. Me fjalë të tjera Kuptimi dhe të Shprehurit e kuptimit. Diturit që përbëjnë Kulturën Islame ase do të jenë asosh që kanë të bëjnë me gjuhën p. sh. Gramatika, Syntaksa, Jurisprudenca (Fikh) dhe Letërsia, ose do të jenë dituri që flasin mbi kuptime dhe idena.

Këto dituri, tue i konsiderue në të gjitha pikpamjet, ndahen në dy grupe të mbëdha: I. Ligjore (Sher-ijje); II Jo Ligjore. Me terma të tjera, Fetare (Dijnijje) dhe Qytetnore (Medenijje).

Fetaret ose Ligjoret janë shumë llojesh: Theologjija (Ilmi Qelam), Bazat e Jurisprudencës (Usuli Fikh) e Hadith; (Tradisioni).

Për sa u përket diturive Qytetnore, këto bëjnë fjalë për mbi diturit e ndryshme Fizike e Naturale si edhe mbi egzistencën, si Medicina, Fizika Filozofia e tjera.

Ne, sikur të pasojshim Kulturën Islame, do të konstatojshim me lehtësi se degët e ndryshme të kërkesës (Bahth) janë

në një bashkim dhe marrëdhënëje të ngushtë njëra me tjetrën. Pa as më të voglin dyshim, ky bashkim dhe kjo marrëdhënëje për sa i përket Kulturës Islame, shfaqen më qartas se në çdo Kulturë tjetër. Misteri i kësaj marrëdhënëje të ngushtë ndofta rrjedh nga se Kultura Islame, në tërësin e saj, ka një pikë fillimi të vetme, prej së cilës mandej u-shpërndanë të gjitha mësimet e ndryshme fetare. Kjo pikë fillimi është: I. Kur'ani dhe Tradisioni, me terma tjera, Libri dhe Sunneti. Janë pra, këto të dy, prej të cilëvevet burojnë të gjitha dhe çdo gjë atyne iu referohet gjer në një pikë që edhe vetë myslimanët derdhën dhe po derdhen krejt mundin që çdo gjë t'ia mbështesin këtyre dy burimeve kryesore. Pra, mbassi Libri dhe Tradisioni janë dy qendra a gurra kryesore të pa shteruna Islame, prej këndeje rezulton se nuk do të jetë një gjë e çuditëshme që këto mësimet të jenë në marrëdhënëje të ngushtë njeri me tjetrin.

II. Nji veprues (faktor) tjetër i randsishëm është edhe se diturit islame u-formuen, afërsisht, në një epokë dhe medium të vetëm. Kështu që po në kohën që u-mblodh dhe u-rregjistrua Interpretimi (Tefiri) Kuranor, në të njëjtën kohë Myslimanët përpigeshin gjithashtu edhe për vuemjen e Syntakses, të Gramatekës si edhe të kërkuarit me njohë diçka mbi Physikë dhe të tjera. Konkluzioni është ky: diturit që formohen në një medium të vetëm shifesh e domosdoshme që të efektoheshin njëra prej tjetrës.

III. Nji veprues i tretë, i cili ndihmon puqëjet dhe lidhjet e tyre njëra me tjetrën, është edhe se këto mësimet ju shtruen efektet reciproke afërsisht.

Të gjitha këto na japin të kuptojmë që investigatori, në Kulturën Islame, po s' pati njoftime të plota, për sa i përket të gjitha degëvevet si edhe të gjitha anëvevet të saj të ndryshme, përgjithësisht, është shumë një vështirësi e madhe për të që të zgjanohet në investigimin që ka parasyshë. Po të marrim parasyshë p. sh. një letrar, i cili, pak a shumë, është i larguar nga Jurisprudenca dhe nga rrënjët e saj, nga Physika dhe nga Qimia, gjindet i nevojitur, në më të shumtën e herës, në rast të këndimit të ndonji teksti arab, për me pasë njoftime të mjaftueshme për sa i përket evolucionit të ideve, Fizikës, Qimisë Jurisprudencës dhe rrënjëvevet të Legjislacionit t' Islamit. Po në të njëjtën mënyrë në qoftë se ndokush nga kërkuesit a investigatorët e Kulturës islame dëshëron të flasij me gojën e një

Filozofi, ka për qëllim kryesuer studimin e idevet Filozofike, edhe këtë e gjejmë të nevojitur, përveç njoftimevet Filozofike edhe për njoftime Theologjike që kanë të bëjnë me besim, si edhe ato që i përkasin mësimet të Jurisprudencës, që kanë lidhje me periodat e ndryshme të rranjëvet të Legjislacionit, dhe së fundi ay duhet të ketë edhe disa njoftime përmbi Historin e Mystikës «Tarijh e TTasawuf» dhe të jetës shpirtnore.

Në nuk dëshirojmë me zënë vendin e një legjislatori dhe as për me u-zgjanue në kërkesat e ndryshme të Jurisprudencës, por na, në një mënyrë të veçantë, duhet që t'i bashkojmë të gjitha këto anë dhe degë të ndryshme me burimet kryesore të Kulturës Islame. Le të themi, po deshëm që t'i përgjegjemi pyetjes së sipërme, diçka prej Historisë të Legjislaturës dhe të evolucionit të 'saj, tue u-përpyekë me i lidhë këto çfaqëje me idet e ndryshme Filozofike. Është e ditur se Legjislacioni në çdo popull është një nga shfaqëjet e pa numurta të jetës mendore, shoqënore, ekonomike dhe politike të tij. Do të ishte një gjë e kotë që të kujtojmë se Legjislacioni Islam mbetet jashtë kësaj rregulle të përgjithëshme.

Është e vërtetë se në këtë Legjislacion gjejmë një element qielluer, një faktor që nuk është njerëzuer. Por, duhet të dihet se elementi qielluer nuk është vënë, veçse për t'iu aplikue dhe për t'iu përshtatë nevojave njerzore. Kështu po të gjykohet natyra, rranja, fundi dhe qëllimi i tij, nuk është vuë për tjetër, veçse për të përmbushë dhe vërtetue kërkesat dhe nevojat njerzore.

Me gjithë këtë, duhet të dihet edhe se, tekstet qiellore nuk janë vù në një mënyrë të shtangët dhe të pa-lujtëshme, që të mos pranojnë diskutimin dhe që të mos jenë të përshtatshëm të ecin krah për krah me kohën, porse janë vënë me qëllim për të qënë të dobishme dhe të përshtatëshme për të gjitha kohët dhe vendet.

Prej këndej kuptohet, vetëvetiut, se propozisioni që u-vendos më lartë që, Legjislacioni në çdo popull s'është tjetër veçse një shfaqëje e jetës mendore, shoqënore, politike dhe ekonomike është një thënëje që i aplikohet së vërtetës. Dhe se nuk mundemi, në as një mënyrë, për t'a kuptue historinë e Legjislacionit në botën islame, veçse atëhere kur të kemi parasyve t'onë një të tillë propozicion (Kadijje). Ndofta, gabimi që bënë disa që studjuan Legjislacionin, do të konsiderohet prej gabimevet më të mbëdhja. Ky rrjedhë nga se ata e patën harruarë këtë propo-

zision ose bënë sikuer e harruanë, tue kujtue se Legjislacioni (Teshri) nuk është tjetër veçse disa tekste të cilët mund t'interpretohen dhe nuk do t'ishte aspak e mundur të dalit jashtë tyre tue dhanë gjykimin menduer dhe tue nxjerrë gjithmonë ligje të reja, për çdo kohë e vend. Ky veprim kësi soji mund të konsiderohet si krimi më i madh që i u-bë ligjit, tue qëndrue, për sa i përket atij, mbrenda disa kufive absolute aq sa edhe vetë Legjislatori nuk pat dëshirue që të qëndrohet aq tepër mbrenda tyre.

Në po deshëm me e pranue parimin e më sipërmë, do të jetë krejt një gjë e lehtë të bëjmë një krahasim, qoftë edhe i shkurtër, në mes të Legjislacionit Islam dhe Legjislacioneve të tjera. Këto legjislacione në një mënyrë të përgjithshme si edhe në tërësinë e tyre ndahen në dy kategori të mbëdha:

I. Qiellore.

II. Toksore.

Qielloret nuk janë tjetër veçse ato që kanë ardhë së bashku me librat e shenjtë: Judaizma, Krishterizma dhe Islami.

Tashti, po të marrim parasysh se Kur'ani, i cili është një Libër Qiellor, njashtu sikurse edhe librat e tjera Qiellore, Ay nuk i shfaqë Ligjët e veprimit në një mënyrë të gjërë por bën fjalë përmbi 'to në një mënyrë të përmbledhëshme dhe të përgjithëshme. Kështu, konstatojmë se versetet Ligjore në 'Të janë krejt të kufizueme dhe të pakta në proporsion me versetet e tjera, me të cilat mund të krahasohen. Ndofta, tue e krahasue me Teuratin dhe Ungjillin, Kur'ani në pikpamje të bërit fjalë mbi këto gjykime dhe ligjë nuk merret me shkoqitjet e tyre porse, si do qoftë, Legjislacioni Islam është Qiellor, njashtu si Legjislacionet e tjera Qiellore: Jahudizma dhe Krishterizma.

Tashti, le të hedhim një sy kundrejt Legjislacioneve jo-qiellore. Këto janë Legjislacione të vûme prej njerëzish: ose do të jenë vû prej individualve ose do të jenë vepër e tufave, e grupeve dhe e shoqërive. Shembëllat më të afërme për këto ligje, kemi ligjet Romake, dhe ato të Hamurabit, etj.

Kjo e ndame kështu, në realitet, nuk është tjetër veçse formale, sepse duhet të kuptohet më së mirit që edhe Ligjet Qiellore, vetë ato, nuk mbeten për pa i u shtrë përshtypjeve toksore dhe mandej edhe rrethanave shoqnore dhe politike.

Tue u-bazue në çka thamë më sipër, konkluzioni del vetvetiu: në mundemi m'e krahasue Legjislacionin Islam me çdo legjislacion tjetër, qoftë edhe jo-qielluer; dhe, për pa i marrë

parasysh legjislasionet e tjerë, mjafton që t'a masim dhe t'a krahasojmë atë me legjislasionin më të vjetër e më të gjërë që është njohur gjer sot, d. m. th. me atë Romakun. Legjislasioni Romak s'asht tjetër veçse disa zakone dhe imitacione që Romakët, prej një kohe mjaft të lashtë, u bashkuanë në mendim për sa i u përket zakoneve dhe imitacioneve të tyre. Mandej, Imperatorët filluanë me i përkufizue, me i mbledhë dhe me i regjistruë. Konkluzioni s'ishte tjetër veçse bashkimi i atyre ligjeve që u-qujtën ligje Romake e që më vonë Justiniani i pat ndarë në kaptina, i pat reshtuarë, i pat mbledhur dhe regjistruarë, me një fjalë i pat rregulluarë.

Ligjet Romake dallohen me cilësitë që vijojnë:

1. — Konvensioni (ûrf) lufti një rol dhe la një influencë shumë të madhe.

2. — Gjërësia dhe përmbajta e këtyre ligjeve për sa i u përket të gjitha problemave dhe nevojave të ndryshme njerzore si edhe të vûmit e tyre për çdo ndonjë problem, zbërthimin që asaj i përket.

3. — Radhimi, të ndarit ndër kaptina të ndryshme dhe mbledhja e regjistrimi i tyre në mënyrë që të këthyerit ndër to të jetë i lehtë, si edhe të mund të nxirren dhe të merren me lehtësi gjykimet e kërkimeve prej tyre. Ndofta, ky është shkak që ligjet Romake patën një fuqi e pushtet shumë të math, gjatë historisë së vjetër, së mesjetës dhe asaj së ré.

Gjithashtu të mbledhurit e ligjëve romake nuk u-plotsua përnjëherë, porse në perioda dhe epoka të ndryshme. Ishte, vetëm përshtypja e këtyre periodave dhe epokave që i shtyri këto ligje t'arrijnë gradën e soçme.

Tashti, po ta lemë më një anë legjislatoren romake dhe, të këthehem legjislaturës Islame, e gjejmë këtë në tërësinë e saj, t'i përngjajë legjislatures Romake, gjithashtu edhe në pikpamje të gjërësisë së saj, në të prekurit e të gjitha problemave jetike dhe shognore. Shto edhe se legjislatorët Islamë, ndofta, i paten kapërxye legjislatorët Grekë e Romakë në këtë më. Muslimanët nuk paten qëndrue vetëm mbrenda problemave, që kanë të bëjnë me botën reale, porse i paten kalue këto gjer sa arrijtën në më të shumten e herës me shpikë dhe me zbulue edhe hipoteza t'imagjinueme. Ata paten përfytyrue dhe u-munduanë që t'ia mbështesin ligjet dhe gjykimet e ndryshme të tilla hipotezave. Nuk patën qënë bindur me *Realitetin*, por e paten kapërxye këtë, tue arrirë në *çka duhet të jetë*, tue u-mbështet mbi probabilitete dhe hipoteza. Legjislasioni dhe sociologjia janë dy dituri më tepër reale se sa dituri hypothetike. Si do që të jetë na duhet të vendosim realin para çdo gjeje.

(Vazhdon)

SADIK BEGA

NJERIU I VERTETE

PIK SË PARI, si djelmosha të ri, duhet të këthejmë verejtjen t'onë drejt rëndsisë së detyrave e të përgjegjësisë të jetës njerzore. Si të ri e kemi kaluar të shumtën e periodës më të lumtun t'udhëtimit të jetës s'onë. Na jemi kah hyjmë në pjesën më të vështirë por të rëndësishme që përgjithsisht quhet jeta njerzore. Disave prej nesh, nga dëshira e tepërt, mund të mos na durohet për me u-numurue në radhën e burrave. Asht koha e volitshme që të këqyrim natyrën e udhëtimit që kemi bërë deri më sot, e të shohim nëse i kemi harruar hapat e matuna e me siguri. Të vëmë oroë a e kemi zgjedhur, me sa të jetë e mundun, rrugën e drejtë që na pajosë me materialin e nevojitur për t'a nxjerrë në krye e me sukses udhëtimin e jetës aqë të dishruem. Si të rinj nuk mund të mos interesohemi mbi problema të vështira, që kanë lidhje të ngushta me t'ardhëshmen t'onë. S' duhet të na shkojë në mend se koha është e pa pjekun për t'a menduar tash, sepse jeta e jonë është tue fluturuar me shpejtësinë e një vetëtime. Në qoftë se shikojmë me kujdes për-qark nesh e të mendojmë se sa shpejt ndërrojnë sendet që na rrethojnë, do të habitemi mbi shpejtësinë e udhëtimit që jemi tue krye.

Udhëtimi i jetës është çuditërisht i pa njoftun në sferat toksore, që nuk të lejon as pushim as shlodhje. Ku jemi tue shkue; ku po na qet rruga dhe se çka është qëllimi i fundit i kësaj vizite toksore? Filozofët dhe t'urtët janë munduar t'i përgjigjen këtyre pyetjeve me rëndsi të parë qysh në fillim të krijimit të botës, e, me gjithatë, zbërthimi i vërtetë duket të jetë largë. Disa përfundime të përgjithëshme, për sa i përket mënyrës, drejt së cilës duhet të rregullohet jeta, me qëllim për të gjetë, deri diku, lumtënin e vërtetë, mund të pranohen pa dyshim. Asht dëshira e urrejtur t'ju parashtrij pikpamjen e vërtetë për naltësimin e njeriut, si një burim të sigurtë të lumtënisë, për mërritjen e së cilës energjitë t'ona janë të pjerruna.

Do të dishëroj që kujdesi i juaj të tërhiqet kah kuptimi

i termës njeri. Ky përbâhet nga dy pjesë kryesore, d. m. th. nga trupi e mendja. Pra bashkimi i trupit e i mendes në një mënyrë të veçantë formon njeriun. Trupi i tij prap përbâhet nga një numur pjesësh, që klasifikohen në çka na i quejmë organe. Organet e të ndimit, të lëvizunit, të tretjes, të menduesit, etj. Mendja, gjithashtu, njehet si me pasë qenë e bâme prej pjesësh, të cilat janë ndá nër fakultete, si fakultetet intelektuale, morale, ndjenjësores e tjera. Nuk âsht qëllimi i emkëtu t'ju numroj një për një organet e trupit ose fakultetet mendore. As q'âsht e rëndësishme të përmend se si fakultetet munden me qenë pjesë të mendes, e në se ato janë mbrenda në mende, sikur njerzit në një kinema, ose mbi 'té, porsillamba mbi një tavolinë. Të tilla çashtje psikologjike janë përtej qëllimit t'em në këtë artikull. Unë vetëm them se njeriu âsht i formuem nga një trup dhe nga pjesët mendore të tij, dhe për shkak të tyre ai thirret njeri.

Ju mund t'a merrni me mend se një i ri âsht aqë një njeri sa dhe një madhor, sepse ai gjithësesi ka duer, kâmbë, krye, stomak e të tânë pjesët trupore, mëdje edhe kujtesë, imagjinatë, gjykim, dashuri, shpresë, frikë dhe gjithë funksionet mendore të përbashkëta me burrnin. Këto pjesë trupore dhe mendore kryejnë të njëjtin lloj veprimi nër të gjitha organizmat. Por dallimi âsht i qartë. Funksionet fizike e mendore të madhorit janë mâ të shvillueme se ato të riut. Duertë dhe kâmbët janë vërtë të njëjta nër të dy, por çdo muskël e rashtë ndër të mëdhejtë dëshmojnë se janë të një forme mâ të madhe, mâ të fuqishme e mâ të zonjat për punë. Asht shvillimi atëhere, që shkakton një ndryshim aqë të math në mes të një të vogëli e të një madhori. Prandaj, gradëve të shvillimit duhet me iu dhânë kujdes i posaçëm. Ju shpesh mund të gjeni ndryshime të mëdha bilé edhe në mes të dy të rinjve.

Na lypset t' i apim kujdes të posaçëm jo vetëm shvillimit t'onë trupuer, por edhe atij të fuqinave e të fakulteteve mendore. Po n'atë mënyrë vetëm shvillimi menduer për pa një ushtrim të matun fizik, nuk kishte për të na kënaqun idenë t'onë të njerzimit.

A âsht e mundun atëhere pra të përcaktohet kufini i shvillimit trupuer e menduer, të cilit lypset t' i arrihet para se njëni pretendon të drejtën me u-quejtë njeri me plot-kuptimin

e fjalës? Një kufizim me masë është, natyrisht, jashtë pyetjes; sepse nër të tana qëllimet botnore një vijë e shëndoshë dhe e preme e qujtun mosha madhore prej ligjit, është gjetun e mjaftueshme. Urtësija e legjislaturës ka parapa një lloj shvillimi trupuer e menduer në plotsimin e një farë moshe, si me thënë 18 ose 21 vjeç. Por le t' a sjellë nër mend djali i rritun se, me gjithë që ai mund t' ia ketë mërrijtë moshës ligjore, por s' ka arrijtun gradën e njeriut të gjykueshëm e të vërtetë. Shvillimi trupuer i është dhurue atij gjatë evolucionit natyral, ndërsa ai menduer duhet të fitohet me mundin e vet; dhe sa më e tepërt të jetë energjia e guximi që ai ushtron në vetvehte, aqë më tepër do të ketë të drejtë pretendimi për me uthirrë njeri i vërtetë. Vlera e tij si qenie njerzore mvaret në suksesin e tij në këtë okupim.

Me gjithë që idea e jonë e tashme është e përgjithëshme për sa ka të bënë sasia e shvillimit që njani lypset të ketë për të mërrijtë ke njerzimi, na s' duhet as pak t' i largohemi zot-sisë së tepërme, a më mirë me thënë shvillimit të pa fund të fuqinave t' ona fizike e mendore që zotnojmë. Le të marrim, për shembëll fuqitë e duerve e të gishtave, se ky organ veprimi ka një kapacitet shumë më të math se sa shvillimit që zakonisht i është dhënë nga vetë natyra. Këtë s' mund t' a kundërshtojë kush. Por ju, kujtoj, nuk e veni re shvillimin e ndryshëm ose të shumë-anshëm e të mundshëm, që mund t' i dhurohet atij me anë t' edukatës. Përdorimi i çekanit të rëndë prej farkëtarit, ngjyrimi delikat i një vizatuesi dhe përdorimi i një vegje janë dishmina t' evolucionit të këtij organi, me gjithë se nër drejtime të ndryshme. Ju mund të jeni kryenaltë në pastërtin e bukur-shkrimit të dorës, që me vjete mundimi e ushtrimi jeni bënë t' aftë t' a fitoni; me këtë ju mund të kujtoni se gishtat t' uej kanë bënë gjithatë që ishte e mundëshme. Mirë po, provojeni një herë dorën në ndonjë mjeshtri tjetër, cilën do që të pëlqeni nga artet e ulta, si me thënë punën e kopshtarit, ose thurrijen e karrikeve, ju me një herë do t' a gjeni vehten se gjymtyrat t' ueja janë fare të pa zonjat në një shvillim këso-dore, që kërkohet për suksesin praktik të këtyne arteve. Sec shvillim i mrekullueshëm i gishtave dhe i atij të fytit diftohet nga një pianist e nga një kangëtor mjeshtër. Prap në qoftë se veni oroë fuqin e këmbëve të një letër-shpërdasi ose të një botë-shetitësi, ju do të habiteni në shkathësin e veprimit që

kâmbët e njeriut zotnojnë, në se ato kultivohen. Shembëlla të pa numurta si këto s' është nevoja t' i përmendim këtu. Shvillimi i plotë a perfekt i një organi trupuer nuk gjindet vetëm n' ushtrimin e tij deri në gradën e fundit në një lloj drejtimi, por nër sa drejtime të ndryshme dhe armonike që të jetë e mundun. E kqyrun nga kjo pikpamje, për dorën e farkëtarit, të nënpunsit, të pianistit, e të vegjë-bâësit, është i nevojshëm shvillimi i plotë, për të cilin due t' ju tërheq verejtjen e posaçme, për me u-numurue në grupin e njeriut të vërtetë.

Po këto shënime aplikohen e zbatohen edhe nër fuqinat t' ona mendore: intelekti, kujtesa, imagjinata, arsyeja, dashuri, simpathija, pasionet, shijet, mirë-kuptimi, naltsimi dhe bukurija e jonë janë t' afta për një shvillim shumë të naltë. Qysh prej Platonit e Aristotelit e deri ke njerzit e mëdhenj të kohve t' ona historia e çdo kohe, vendi apo krahine është plot shembëlla xhenish, që i kanë naltue fuqitë e tyne intelektuale në gradën e meritueshme. Na këndojmë historina mbi kujtesat (memoire) e çuditëshme t' individualve si n' Europë dhe n' Azi. Thohet se filozofi Pascal nuk harronte kurrë një send që e thoshte ose bante në gjithë jetën e tij mendore (rationale). Kështu për një bibliotekist Italian thohet se i përmendëte krejt volumet e bibliotekës së tij dhe, por sa t' i kujtohesh emni i autorit, sa do i vjetër t' ishte, ai e sillte ndër mend se ç' libër ishte. Edhe një Hindian, s' ka shumë kohë para, nga ana e Bombajt (Indi), me një kujtesë të jasht-zakonshme, aqë sa thohet se ishte i zoti të përsëritte, qysh prej fillimit e në mbarim, fjali dhe fraza të shumë gjuhve të ndryshme, q' i këndoheshin para tij, pa pasë kurr farë lidhje fjalitë njâna me tjetrën. Kur Newton-i e lidhi provën e të râmrit të një molle me atë të Hânës kundrejt tokës, a nuk ishte triumfi i imagjinatës së shvillueme në përplotsim!

Kapaciteti për shvillimin e çdo funksioni vetmas të trupit dhe të mendjes s' onë, tue qenë kështu të pa mbarim, kishte me qenë sigurisht një njerzim i shkallës së ulët, po të rrijshim të kënaqun vetëm me shvillimin, sado të naltë, të një ose disa organeve e gjithë të tjerat të ngelshin të pa lëvizëshme ose të mpita. Shembëlla nuk mungojnë edhe për disa, që fuqitë mendore i kanë jasht-zakonisht të shvillueme në dâm të të tjera-vet. Ju mund të keni ndigjue no një djalë që, pors i një makinë llogaritëse, ep zbërthime të gatëshme të problemave të

vështira arithmetike, por që është hutaq (guhak) në çdo pikpamje tjetër. Shumë naltë kanë arrijtun mendësisht njerzit në sferat shkencore, por që shpesh mund të futen në radhën e tutkunëve (të trashë nga mend), — për sa i përket naltimit dhe filozofisë së bukurisë — aqë sa është plotsisht e mundëshme që njani të jetë kundërshtar i Milton-it dhe Shakespeare-it, se këta nuk dhënë shembullin e meritueshëm, d. m. th. këta vetëm në pikpamje mendore kanë qënë të shvilluem kurse në të tjerat jo. Shvillimi i pa rregulltë i fakulteteve ndjesore, si dash-tuni e simpathi për drejtësi, nuk gjindet rallë në radhën e shumë personave. Në raste të tilla neglighenca e një shvillimi armonik i fakulteteve të tyne ka prodhue rezultate të mjerueshme. Pretendimi i njerëzve kësodore për të mirë duhet të mbahet me rezervë.

Nga konsiderimet e më sipërme të njeriut të vërtetë, na nxjerrim idealin më të naltë të njerzimit, në të cilin gjithë fuqinat fizike e mendore, në të njëjtën kohë, mërrijnë shvillimin e tyne të gradës më të plotë, të mundëshme. Kur kësaj konditë i është arrijtë çdo organ i trupit e i fakultetit të mendes së tij është i zoti të kryejë funksionin që i është caktue në mënyrën më të pëlqyeshme të marrun me mend. *Gjymtyrat e tij janë aqë shumë të stërvituna sa që janë gati të përmbushin çdo lloj pune sa do e vëshlrë ose delikate qoftë. Sytë e tij janë të mpreftë sa me dallue edhe ndryshimet më të imta të hijes dhe ngjyrës e depërtojnë në thellësitë më të mëdha, të largëta. Veshët e tij, barazisht, ndijnë buçitjen e naltë të një katarakti a të një topi, gjithë ashtu kapin, dhe shijojnë notat e pa dallushme të armonisë në muzikë. Ai është një ekspert në të gjitha çashtjet e shijimit e të nuhatunit. Ndija e të prekunit kë ai është hollësisht e ndijshme sa që me marrë vesht edhe lëvizjen e ajrit e drithmën e etherit. Ai posedon një konstruksion trupi të fortë. Krahnoiri, mushkënit e stomaku i tij kanë arrijtë konditën më të shkëlqyeshme të shëndetit e të fuqisë, sa me e bá atë aktiv, energjik, durimtar në mundime dhe gati me përballue lodhje të randa e vështirsina të çdo lloji qofshin, kohe, klime ose vendi. Një maqinë e tillë vërtet e shvillueme ka një mendje me të vërtetë të përsosun. Memorija e tij është një depo e çdo lloj informate e njoftimi të dobishëm. Zotsia e imagjinatës së tij bashkon qiellin e tokën dhe krijon botna të tjera të reja për bukuri dhe elegancë që kurrë nuk është andrrue në poezi ose filozofi. Kën-*

dimi dhe gjykimi i tij janë mjaft të gjânë. Fuqija mprehse e arsyelimit të tij depërton mështetësitë më të errëta dhe ep gjykime me vend tue pasë besim të pa tundëshëm. Pjesa morale dhe ajo e ndjenjave të mbrendëshme të natyrës së tij janë po në atë mënyrë të kultivueme mjaftësisht sikurse intelekti. Pasionet dhe oreksët e tij janë kujdesisht të rregullueme. Dashurija dhe simpathija, bāmirsija e mirë-njoftja, janë të pa shterruna. Tek ai shija për bukurin, fisnikija dhe naltësimi janë krejtësisht të zgjedhuna e të mbaruara. Ai është një babë i mirë, një burr i dash-tun, një bir i bindun e i detyrës, një alldhetar i vërtetë e pa interes, një nënshtetas besnik dhe një burr i virtutshëm; shkurt një zot mhi tokë!. Se sa jetë e lumtun dhe e pa përshkrueshme do t' ishte një e tillë! Rruzullimi është destinue t' i api atij lumtënin e kërkueme. Më duket se, lumtënia e vërtetë, që është qëllimi i fundit i jetës s' onë, është sinonime me njeriun e vërtetë, të cilin u-përpoqa t' a përshkruej më sipër. Ky pra duhet me qenë parimi udhëheqës i gjithë veprimeve t' ona e spro-vimi kryesuer, me anën e të cilit sjellja e jonë individuale, private, dhe shoqnore lypset të gjykohet. Mundet, gjithashtu, të rekomandohet si një mjet praktik, i sigurtë për t' u-ndjekë pa frigë se mos bjesh në kundërshtime ose dasina.

Pra, njeriu i cilsuemun sipër asht vû si një ideal para mendes së njeriut të civilizuem, vlefëta e të cilit, përpara nalt-simit t' onë, është e llogaritun. Pa pasë parasysh këtë lloj ideali, ose të pakën shembullin e tij, na s' mund t' i a arrijmë qëllimit t' onë. Këtu gjindet dobija dhe nevoja e të mësueimit historinë Islame. Pse aty gjejmë jo vetëm shembullin e idealit më të naltë, Njeriun e vërtetë, por gjithashtu ndeshim qenie idealizmi, bij të bindun kundrejt detyrës, mbretë të virtutshëm, persona dashamirës të dashtunisë vllaznore e të vetë-mohimit, besnikë deri në palcë, ushtarë trima, të shvilluem fizikisht e mendësisht, njerëz me moral e karakter të shëndoshtë, që na apin shembullin e vërtetë të shvillimit njerzuer e që duhet të ndiqen e të gjurmohen për të mirën t' onë e të krejt njerzimit.

Mjeti për t' i a mërrijtë njerzimit të vërtet mvarët kryesisht nga edukata ose, për me qenë të pa gabûshëm, kultura. Natyra, pa dyshim, është një agjent i fuqishëm në këtë vepër, por askush s' do të kënaqesh të mbështetej në natyrën pa mend në një interesim kaqë serioz. Një farë e braktisun (e hudhun) nga era mund të bjen në një tokë pjellore e të shpërthejë në

një pemë gjiganteske pa kurrfarë ndihme veç asaj të natyrës bujare. Por bujku nuk mbështetet vetëm mbi natyrë për m'i rritë dhe pjekë bimët. Ai plehnon tokën, ujit barishtat, punon misrin e përdorë një mijë e një mënyra për t'i përmirsue ato ashtu si është më mirë. Kultivimi i vërtetë është i domosdoshëm për sukses. Vetëm ai i ka bërë që disa nga bimët e zarzavatet t'ona t'ia mërrijnë përmirsimit të çuditshëm që kanë sot; gruni dhe thekni, tek të cilët mvaret jeta e jonë, natyralistët na tregojnë se ata n'original s'ishin më të mirë se bari i zakonshëm që shkelim. Patatja dhe lakna ishin, jo shumë shekuj para, krejt të pa vlefshme e gati barna helmuese, të pa përshtatuna për përdorimin njerzuer. Mirë po ato tash, me anë të kultivimit, janë shvillue në formën që kemi atë të dobishme. Kultura në botën njerzore i përgjet asaj të bimëve. Qëllimi i këtyne është evolucioni i qenieve njerzore ndër të gjitha pjesët e tij. Pa kulturë, fëmija me ndihmën e natyrës mund të rritet në madhor, porse trupi dhe mendja e saj nevojitet për një shvillim të plotë e të dishruem, të cilin vetëm kultura ia ep. Kultura e organeve fizike dhe e fakulteteve mendore, gjindet në ushqimin e posaçëm dhe n'ushtrimin e shëndoshtë të tyne. Për me dalë i suksesshëm duhet me ia fillue qysh herët në jetë; sepse trupi e mendja veprojnë e riveprojnë njana me tjetrën, dhe kultura armonike e njënës pjesë tërheq atë të tjetrës. Kur, p. sh. ushtrimi bëhet me qëllim që të forcohet trupi fizikisht, intelekti do t'udhëhiqet deri atje ku duhet e të ndalet atje ku ka kufinin e vet. Prap në ndërtimin e natyrës s'onë disa fakultete mendore janë gati m'u-mposhtun prej rritjes së tepërme të të tjerave. Simpathija, dashtunija dhe bâmirësija e humbin forcën e gjallnin e tyne për shkak të shvillimit të pa kohshëm të zemrimit, të emirës e të lakmisë. Ushtrimi i një kontrolli të posatshtëm mbi një numur pjesësh duhet t'ekzistojë, që kështu të tjerat të mund t'ia arrijnë një rritjeje të shëndetshme. Mjetet që do të përdoren për t'ë të mund të prodhojnë një rezultat të harmonizueshëm, që kështu, të gjitha së bashku, të marrin nga një gradë zgjutsie, shkathësie dhe eksperience. Rruga për ke njerzimi i vërtetë duket të jetë e vështirë, prandaj ndihet nevoja për një udhëheqës të meritueshëm, si e përmenda më sipër.

Prirrja për kë një udhëheqës apo mësues kësodore është

e ngjyrueme dhe e themelueme në natyrën njerzore, e cila nuk mund t'a gjejë përveçse ke Udhëheqësi i Math i Islamit. Kjo është rrjedhja e natyrshme për m'e gjetë njeriun e vlefshëm, të cilin një shumicë e madhe e ka realizue, sikur e dishmojnë sistemet e ndjekuna. Po, rrugën për ke një njeri të tillë e gjejmë edhe në sistemin e jetës Fashiste, drejt të cilit edukata shekullore dhe ajo fetare hecin krah për krah. Dhe i gjithë ky sistem simbolizohet ke një person, që paraqet shembullin e një njeriut të vërtetë.

Për me i a mërrijtë idealit, për të cilin jemi tue folë, jeta mund të ndahet në katër perioda. 1) Prindërit të kenë kujdes për me i rritë fëmijën sa më të shëndetshëm që të jetë e mundun. Ata duhet të bâhen shembulli i vërtetë dhe këshilltarë të mirë për t'i drejtue filizat e shpresës së nesërme drejt dashtunisë s'atdheut e të bashkimit kombtar. 2) Ata lypset të ndihmojnë n'edukimin e fëmijës tue i bâ këta të sjellshëm e model për të tjerët si dhe t'u ngjallin atyne dashtuninë për mësim. 3) T'i nxisinë ata për shvillimin trupuer e intelektual drejt një karakteri të naltë e të pa thyeshëm. T'u shtjenë atyne zellin për punë që kështu të mos u vijë marrë (turp) për çdo lloj pune që t'iu dalë para, e, çka më tepër punën t'a kenë për nder e mburrje. Pse punët e ndryshme janë ato, që forcojnë trupin nga çdo pikpamje. Ata duhet t'iu shtijen në shpirt atyne dashtuninë për të formue familje, me qëllim që me shvillue dhe zgjânue më tepër fitimin që pastaj t'a spenzojnë këtë bujarisht nër bâmirësina shembullore. Familja e bân fëmijën të kultivojë pjesën e ndjesinave të mbrendëshme morale të natyrës së vet. Me i mësue se si i shërbehet atdheut për me kultivue dashtuninë e ndjesive të zemrës, që kështu të sakrifkohet çdo individ për të mirën e përgjithëshme, ashtu si urdhnnon Islami dhe Fashizmi. T'urtit e mëdhenj i kanë dhënë rëndësi të posaçme kësaj pjese të kulturës, të cilën, ata e kanë quejtë të detyrshme për çdo njeri.

Në se është e mundun për një natyrë njerzore kësilloji për t'ia arrijtë shvillimit të mbrendshëm të ndjesive për pa hye në marrë-dhânie shtëpijake, është një problem psikologjik, që s'kam qëllim t'a shvilloj këtu. Por mund të thom me siguri se bekimi i grues e i fëmijëve është shumë më afër e më tepër i dobishëm drejt këtij qëllimi se sa ajo e një filozofi spekulator, që i flet teorinë të thata e të pa zbatueshme popullit.

Lanja mbas dore të kësaj bote pat pasë një tërheqje të veçantë në menden njerzore si pajosje e madhënisë morale, por sot i ka ra vlefta. Pa dyshim ideali për prefeksionim nuk mvaret në hekjen dorë nga bota, por n'atë të shërbimit të jetës familjare e kombëtare. 4) Fëmija sa më shumë të rritet e të përparojë, duhet t'ia kushtojë vehten mirë-qenies së bashk-atëdhetarëve tue i kultivue të gjitha virtutet aktive të veprimit të vet, drejt shtimit të dijtunisë e të moralit. Ndjenjat e saj të jenë të drejtueme nga urrejtja e qejfeve të mëdha dhe t'ia dedikojë vehten mendimeve estetike të natyrës që të zbulojë mështetësinat e rruzullimit, që i ndihmojnë njerzimit në përparim. Kjo lloj edukate e divotshmenie të përjetshme, kushtue njerzimit, ka një element naltsimi, që vlen t'i epet një mendim i thellë e serioz. Nuk kam qëllim të them se është i kollajshëm për tash, në kundërshtim me gjendjen e sotshme, por shpirt-madhëria e Duçe-s, që e diktoi zgjanimin dhe shvillimin e vazhdueshëm të jetës s'onë, tue pasë parasysh njeriun e vërtetë, s'duhet të lehet mbas dore prej nesh, dhe se lypset të jetë parimi i çdo sistemi edukativ.

Qëllimi i fundit i edukatës duhet të jetë mërritja ke njeriu i vërtetë. Keq-kuptimi i këtij parimi, nga disa, ka shkaktue të meta n'edukatë. Preferim i është dhënë kultivimit t'intelektit ndërsa fuqitë emocionale dhe estetike janë lënë mbas dore. Kuptohet se është metoda e mësimit, që nuk ka dhënë frutin e dishruem. Rëndsi i është dhënë dijtunisë materiale, e cila i ka bërë djelmënin gati të pa mëshirshëm. Materializmi ose shkenca, në vet-vendi, nuk shahet, por influenca që ajo len mbas është e pa mëshirshme për pa u-shoqnue me subjekte ma zemër butë, të cilat me anë t'imagjinatës ndezin ndjenjat fisnike të zemrës njerzore. Zemra ka aqë rëndësi sa dhe kryet. Na s'duhet të neglizhojmë as njënë.

Asht edukata materiale ose atheizmi që ka mbulue një pjesë të madhe të botës me ashpërsi dhe vetë-pëlqim. Ajo i ka udhëheqë disa në lakmina personale të pa kufishme në çdo kohe, e, këtë vetëm me plotsue nevojat e veta vehtiake. Ari është bërë Zot dhe morali një hipokrizi.

Edukata duhet të pajtojë me çka u-përshkrue më sipër, pse atëhere ajo do të na drejtoi kah qëllimi i jonë i vërtetë. Ajo duhet të jetë e përgjithshme që të mos e ndaloj specialitetin t'onë n'asnjë degë. Po, ajo duhet të na api një dijtuni

të shëndetshme, që të mpreh zgjuetsinë mendore e të shvillon drejt nga njerzimi i vërtetë. Atëhere dhe vetëm atëhere ajo do të na bâjë që të kontrollojmë vështirësitë e çdo lloj pune e studimi të veçantë në qoftë se i qendralizojmë të gjitha fuqitë t'ona mbi 'të.

Njeriu, me gjithse, s'është i pajosun nga natyra që të bâhet specialist i çdo dege, por akoma është e çelun për 'të të vazhdojë e të ndjekë rrugë të shumta e të dobishme për deri sa t'ia mërrijë njerzimit të vërtetë, për të cilin ai përpigjet me plot të drejtë. Po, e mundëshme është për 'të të kërkojë dije të shëndoshtë, zgjutësi e aftësi ndër artet mekanike, në fuqitë e bisedimit instruktiv, në dashtuni e bâmirësi kundrëjt njerzisë e shtazëve si dhe të një mijë e një veprave të dobishme dhe elegante, me konditë që të krejt fuqitë e tija të jenë rregullisht të kultivueme drejt urdhnave që na ven para Islami. Ky duhet me qenë qëllimi dhe objekti i edukatës të çdo njânit nga ne, si myslimanë.

Shpresoj se nuk do më keni keq-kuptue në mbrojtjen e tezit t'edukatës së përgjithëshme. Shifet se edukata të ketë qenë e sipërfaqëshme, por me gjithatë në t'ardhëshmen priten shumë të mira. Ju zotnori një zell të fortë për studime të shumë llojshme e të një numuri gjuhësh të hueja, por a nuk do t'ishte mâ mirë sikur nër pushimet të bâheshit edhe roba-qepës, këpuctarë, bujqër, âmbëltorë, mjeshtër, fabrikantë etj? Ky ndryshim, ndoshta, do i duket, shumë-kujt i pa pëlqyeshëm, porse është i domosdoshëm për shvillimin trupuer e pjesërisht edhe i atij menduer. Shvillimi i shëndetshëm i stomakut vjen kurse i epen atij gjellë të ndryshme e të dobishme. Por ç'ka do të pësonte ai sikur të mbushesh me një varg gjellësh t'âmblla? Po n'atë mënyrë, shvillimi i fuqive intelektuale, nuk don që mëndja e jonë të mbushet e të ngjishet me gjithëfarë faktesh ansiklopedike. Në të njâjtën mënyrë edhe trupi ka të drejtën e vet të shvillimit.

Tue pasë parasysh faktet e mâ sipërme, besoj se pikpamja që kam citue mbi shvillimet e ndryshme e armonike të kapaciteteve t'ueja fizike e mendore, që përbâjnë njeriun e vërtetë, nuk do ju duket si një gjâ e pa zbatueshme. Shëmbëlla kemi në mes t'onë dhe se pjesën mâ të mirë të jetës s'uej, si djelmosha e të ri që jeni, e keni para. Juve u ka hije vetëm të përpigji tue i hedhë hapat përparimtare drejt njerzimit të vërtetë, të cilin na e përcakton Islami me Fashizmin.

REDAKTORI

DETYRA E GRUES

CDO pjestar i mërrishëm e i mendshëm i shoqënisë ka një detyrë për t'a përmbushë; kështu edhe grueja si pjestare e saj ka një detyrë shumë delikate. Për t'a theksue e përmendë se cila është detyra e saj, mjafton me kujtue e spjegue një frazë me shumë rëndësi e kuptim të plotë të Mm. de Maintenon-ës, të cilën Luigji i IX e quejti «Arsyeja». Para se me përmendë këtë frazë, është mirë me dijtë se ç'ka qenë e ç'kompetencë profesionale ka pasë kjo grue e njoftun për veprat e saj. Kjo i gjykonte hollësisht burrat e gratë sidomos këta të fundit, mbassi ka pasë rasë me u-marrë me vajzat e me i mesue në shtëpinë edukonjëse të Saint-Cyrit. Me këtë rasë ajo e njofti mirë psikologjinë femnore. Sikurse Molier-i, e Fenelon-i, kështu edhe kjo i dha rëndësi të madhe edukimit të gruesë në pikpamjen familjare e shoqnore; për këtë shkak ajo u-përpoq shumë edhe pat si qëllim me i dhanë vajzës një formim praktik e serioz, një edukim të fortë, që t'a përgatiti atë me përmbushë rrolin e vet e me kuptuë misionin, që i përket, kur të bâhet grue. Ajo ka thanë: «Gratë e bâjnë edhe e ruejnë shtëpinë».

Nashti del pyetja se në ç'gjâ e në ç'mënyrë mundet me u-aplikue ky veprim bâmirës? Natyrisht, fjalën «shtëpi» e marrim me kuptimin familje, votër, patrimonî. Mbajtja, mirë-vajtja, mbikqyrja e lumnia e familjes u përket gravet. T'a shikojmë çashtjen në pikpamje materiale: grueja ka në dorë organizimin e mirë të shtëpisë, kujdesin, guston, qeverimin, pastrinë shëmbullore, etj. Grueja e mirë vetë ose me shërbëtorë me ânën e drejtimit inteligjent e të mirë e bân votrën familjare të kândëshme e tërheqse. Grueja prap, tue i rregullue shpenzimet e shtëpisë me ekonomi, duhet me organizue bu-

xhetin e shtëpisë, të mos e kalojë shumën e fitueme, të ruhet nga shpenzimet e padobishme e të kota, t' a lënë luksin e të bënë shpenzime serioze e të nevojshme, që korrespondojnë me nevojat e domosdoshme të fëmijet e të shtëpisë. Në qoftë se grueja din kështu me pasë një vëzhgim për të gjitha, sido që të jenë të hollat, që shpenzon, ajo mundet me bënë ekonomi, me shtue kapitalin e familjes edhe me forcën e gostos e të kujdesit e zbukuron e e mobilizon shtëpinë. Atëhere banesa ka me pasë më çmim e më shije; çdo njeriu i pëlqen me shkue aty; burri e fëmijet e saj kanë me u-kthye me dëshirë; votra e saj ka me u-forcë, dashunija familjare ka me u-shtue.

Porse, si do të jetë i plotsuem ky organizim i mirë material i shtëpisë, prap është një gjë e pa mjaftueshme, po që që grueja nuk ka çilsina intelektuale e morale, në mënyrë që të shtrijë influencën e vet mbi burrin e fëmijet. Një amvisë e shtëpijare e mirë nuk ka të blemë; e një grue, që nuk din me gatue bukë e gjelle e me sigurue një shërbim të mirë, nuk kishtë me qenë një grue e vërtetë e e denjë për bashkëshort. Për veç kësaj, në kohën e soçme grueja duhet me dijtë, tue mos lënë e harrue detyrën, që i përket, edhe me përmbajtë e me ndihmue burrin e vet në mjeshtërinë e tij, në çqetësimet e gajlet, me rritë, me mësue e këshilluë fëmijet, me u kallë dashunin për Atdhe e njerë e për çdo gjë tjetër të dobishme, me u dhënë të gjithëve përshtypjen se ajo ka një shpirt të drejtë. Po që e mundun, ajo duhet përsëri me qenë në korrent t'idevet të reja, që kanë të bëjnë me rritjen e edukimin e mirë të fëmijet; duhet të pajiset me kulturën e nevojshme e sidomos me u dhënë më gjithë zemër, mendje e shpirt pas shtëpisë; ajo nuk duhet me kërkue dëfrime të kota jashta e të mos ketë të drejtë kërkese pamvarsije. Përndryshe, në qoftë se provojmë që grueja vepron në një mënyrë të përkundërt, atëhere don me thënë m' e lënë mbas dore shtëpinë, m' e çue në greminë patrimonin e m' e shpërda familjen. Grueja mundet me qenë, ndoshta, edhe përtace, e pa kujdesshme, e lehtë nga mendja, mendje naltë, etj. Në këto rasa të ndryshme shtëpija atëhere mbahet

keq, e mbrendshmeja nuk ka as një ândje, e të gjithë pjestarët e familjes kërkojnë me jetue jashtë; natyrisht, atëhere ipen mbas dëfrimeve disa herë të kota e të kushtueshme, disa herë të pa moralshme e të dâmëshme për shëndetin. Grueja mendje-kotë nuk mendon veçse vehten e vet: me u-veshë e mbathë, me u-stolisë, me dalë jashtë e me u-dukë e bukur. Fëmijet atëhere lihen në mëshirë të natyrës, pa mbikqyrje ose në dorë të dadavet e të përbuzun me çdo mënyrë. (Sa janë për t' u mjerue ato fëmijë që rriten në duar të shërbëtorëve, të pa ditun, sa është për t' u-mallëngjye kur ndigjohen fëmijë që porta, tue që e kërkojnë nanën se kur kthehet nga shetitja!)

E, natyrisht, burri i të tillë grueje nuk vonon me u-nda nga një shoqe kokete, shpenzuese e e pa meritueshme, që nuk mundet as me drejtue shtëpinë, as me rritë fëmijet e vet. Po ky përfundim del edhe nga një grue, së cilës nuk ja rrok mendja mirë apo s' e din se ku është detyra e saj; kjo nën preteksin e studimeve të artëve apo të dhënunit e vehtes gjoja për të mirën e të tjerëve, çkatrron gjithashtu shtëpinë e vet edhe, për okupime që asaj i pëlqejnë me kohë ose që ajo dishiron a lakmon një dobi më të përgjithëshme, si nënpunsi, tregti, lenë detyrën e vet modeste, porse të shenjtë, rruajtjen e trolit familjar.

Nga ky përshkrim i vogël, shohim se sa e drejtë ka qënë fjala e Mm. de Maintnon e ç'rrol kryesues luejnë gratë në sositë, sepse organizimi i mirë i familjes varet nga grueja, e që shoqëria e shteti nuk lulëzojnë e përparojnë, veçse kur janë të përbâmë prej familjeve të disiplinueme, ku mbretton rregulli, bashkimi e paqja. Të tilla familje të disiplinueme, ku ruhen e mbahen traditat e shëjta të detyrës e të ndershmisë, i gjejmë më tepër se kudo në Gjermani e Itali. Këto familje janë që kanë bërë forcën e ketyne dy shteteve. Prandaj çdo shtet që pranon një doktrinë fetare, dishiron bashkimin kombëtar e nasionalizëm të vërtetë, duhet t' a ketë gjënë më të rëndësishme me i futë në shpirtin e gravet këta të vërtetë, me u mësue parimet morale të vërtetë të predikueme nga feja e arsyeja, mbi të cilat ka me u-ngrefë

vatra familjare, e me u mësue se ku qindron detyra e tyne e parë e më në fund luminja e vërtetë.

Nga sa shifet, na nuk mund të pretendojmë që grueja Shqiptare sot për sot të jetë në shkallën e një nâne të mirë, me përjashtim të një pakice, sepse i mungojnë traditat e kultura e nevojshme, porse është edhe një ve-për antinjerëzore e antipatriotike që grueja e jonë të rrijë gjithnji në një shkallë fare t' ulët. Që t' ja mbërrij-më qëllimit, duhet që vajzat të ndjekin shkollën, pastaj të tjera të frekuentojnë kurse, të ndigjojnë konferenca nga kompetentë, të ndigjojnë predikime nëpër faltore mbi higjienën shtëpijake, mbi rritjen e fëmijet mora-lisht e fizikisht. Natyrisht, kjo barrë i përket më tepër Ministrisë s' Arsimit, e cila përveç organevet të tjera, ka në dorë me dërgue mësuese në kohë pushimi nëpër katunde e me u dhënë mësimë konkrete katundarevët mbi rritjen e fëmijet e higjienë.

SASHI

SHËNIM: *Shembëllat e subjektit të Z. Sashi janë të shumta edhe në Historinë e Islamit. Në do të preferojshim me shkruë diçka mbi një grue të madhe që emëri i së cilës do të mbetet i pa vdekshëm në Historinë Islame:*

H A D I X H E

(KËNAQËSIA E ZOTIT QOFTË MBI TË)

Të marrunit e H. Muhammedit me punë tregtare, drejtë-sia dhe besnikëria tek Ai ishin dy motto kryesore, qysh në njomësinë e thonjëvet të Tij e gjersa u-njoft me zonjën e madhe Hadixhe të bijën e Huwejlid-it—e cila ishte një zonjë e pasur e fisnike që u-emnonte në kohën e Ignorancës «Tahire» dhe «Zonja e Kurejshit»—shkahtuënë një orientim të randësi-shëm në Jetën e Tij. Zonja fisnike e naltë-përmendur e vuni H. Muhammedin kujdestarë në tregtin e saj tue e dërguë në Damask. Në këtë tregëtië u-fituë dyfishi i fitimevet të më parëshme, kështu, Ajo ja shtoi pagesën tue kërkuë edhe që të

fejohet me Të, në atë kohë që Ai kishte mbririm moshën njëzet e pesë vjeç dhe ndërsa Ajo ishte një gruë e vé dyzet vjeçare. Nga të dy palët ishin zgjedhë për dëshimtarë në martesë : për Hadixhenë, xhaxhaj i saj, Amr ibni Esedi; për H. Muhammedin, xhaxhaj i Tij, Ebu Talibi. Ndërmjetës në mes të H. Hadixhesë dhe të Profitit pat qenë e qujtuna Nufejse e bija e Munejë-s. Dotën (mehr) e pagoi Ebu Talibi, xhaxhaj i Tij i cili pat mbajtur edhe një fjalim shumë të bukur për lavdërimin e H. Muhammedit dhe të H. Hadixhesë. Në këtë fjalim u-ndodhte gati edhe xhaxhaj tjetër i H. Muhammedit, H. Hamzai. Në këtë fjalim, Ebu Talibi shfaqti të gjitha meritat dhe fisnikërin e H. Muhammedit, me gjithëse pasunia e këtij ishte e pakët. Përmbajtja e këtij fjalimi asht kjo :

« Lavdërimet qofshin për Zotin I Cili na bani prej zbritësve (Gjenealogjisë) të Ibrahimit dhe prej farës së Ismailit, Ai bënë që Shtëpia e jonë të frekuentohet prej Vizituesëve, që Qyteti i jonë të jetë i Shënjtë (Beledi Haram) si edhe na bani kryetarë përmbi njerëz. Shtoj edhe se Muhammedi, bir i Abdullahut dhe nipi i em asht një person që nuk mund të matet me 'Të as një djalë tjetër prej Kurejsbit, Ai asht ma i preferuëshëm prej çdo njenit prej tyre si në pikpamje mirësie ashtu edhe në atë merite, në bujarië, intelligjencë, madhnië, lavdi e fisnikërië, me gjithë se pasuria e tij asht e pakët por se pasuria s' asht tjetër veçse një hije që shduket ose një gja e pa-qendrueshme që vete dhë vjen përsëri etj. ».

Martesa e H. Muhammedit me H. Hadixhenë u-pasue prej gjashtë fëmijëve prej të cilëve asht edhe Fatimeja e cila ma vonë u-martue me H. Aliun, të birin e Ebu Talibit, Sa për martesën e H. Muhammedit me Zonjën Hadixhe do të mjaftojshim me kaq pa dhanë shkoqitje dhe detaje ma të gjata; por, me këtë rast nuk do të neglizhojmë që të përmendim edhe se Hadixheja Ishte ajo gruë që gjatë gjithë jetës së saj pat ndihmuë dhe enkurajuë, me gjithë çka asaj i vinte për dore, Profitin : si para se t'i vinte Profetësia ashtu edhe mbas' saj. Në kohën që Atij po i ngarkohej barra e rëndë e Profetësisë dhe kuër po kthehej prej malit Hira tue u-dridhun prej frikës dhe trishtimit që e kishte kapun, kuër Ai pë për të parën herë Engjëllin e Revelatës Hyjnore i cili po i drejtohej me fjalën "K ë n d o" (Ikré) dhe Ai i përgjegjej : "Ç' ka të këndo, nuk di me kënduë" (Ma Ene bi Kariin), Ai u-gjend me një herë në

praninë e kësaj gruëje që me shpirtmadhësinë e saj tue gjykue hollë gjendjen e Profitit të Math nuk bani tjetër veçse me i forcuë shpresat e Tij që do të realizoheshin pa tjetër në të ardhëshmen. Ai, kuër u-gjend para të shoqes pat thanë: “Mbështillmëni, mbështillmëni!” E mbështollën gjersa ju larguë trishtimi. Ai e pat lajmëruë edhe H. Hadixhenë për gjithë çka Atij i ishte Zbulue. Ai shtoi edhe se ishte frikësuë për së tepri! Ajo, ju përgjegjte: “Jo, Për Zotin nuk të mbàrron Perëndia kurrë Ti!” Mandej, Hadixheja, me një herë, pat shkue te kushërini i saj, i qujtuni Vereka ibni Newfel, i cili ishte një nga pleqtë e urtë dhe dijetarë që kishte pasë mësue Ungjillin që e këndonte dhe përmendshë; Ajo, i drejtohet atij kështu: O kushëri i em! ndigjo se çka dëshëron me ju dëftuë nipi i juëj! H. Muhammedi, a. s., e lajmëroi për çdo gjâ që i ndodhi dhe Vereka u-përgjegj në këtë mënyrë: “Ky asht Engjëlli i Revelatës që i pat ardhun edhe Moisehut”, dhe mandej, Ai pat shtuë: “T’isha i ri për me të ndihmuë n’atë kohë që Kombi i yt do të të nxjerrin jashtë Qytetit!” I Dërguëmi i Zotit tha: “A do të më nxjerrin ata!”, Vereka u-përgjegj përsëri: “Çdo burrë që ásht ngarkuë me një mision si ai që t’u ngarkuë Ti ka qenë anmiqësuë, por, po të jetë se ditët e mija do të më lejojnë me rnuë edhe ma gjatë, kam me të ndihmuë me të gjithë fuqinë t’eme” Ky nuk rnoi mâ gjatë që të mundëte me e çuë në vend premtimin e tij.

I Dërguëmi i Zotit e kishte bâ zakon qysh ma parë të shkuëmen e shpeshtë në malin e Hirasë. Njij ditë ndigjoi një zâ që i vinte prej së nalti dhe tue kthyë sytë n’atë drejtim, me një herë, pa Engjëllin që i ishte shfaqur herën e parë. Me të shpejtë, u-kthyë për në shtëpi dhe me të arritun tha: “Mbulomëni, mbulomëni!”. Dhe, tue qenë në këtë gjendje, me një herë ja mbërrini Engjëlli (meleq) që i pruni Fjalët e Zotit: “O i Mbuluëm, çou dhe Këshillo njerëzit! Zotin tand madhënoje, dhe teshat e Tú pastroji, Largoju ndytësinës, etj...” Ky asht fillimi i Dërgesës së Profitit, paqi i Zotit mbi Të. Edhe në këtë rast Hadixheja u-vërtetuë se ishte përkrahësja mâ e madhe e idévet të Profitit. Ajo numurohet ma e para e gravet që i pat besuë dhe që i solli bindje Atij; Ajo e trimnonte tue ja shtuë shpresën e të Kryëmit të misionit të Tij plotësisht. Qysh në këtë kohë, Feja që na mësoi Profiti, u-përqafuë, jo vetëm prej Kësaj gruëje të famëshme e fisnike, por edhe prej

shumë të tjerëvet. Ishte e para e gravet që hynë në Islam tue i shërbyë këtij në një mënyrë të mrekulluëshme. Në kohën që H. Muhammedi u-martuë me këtë Zonjë të madhe, Ai pat gjetur në shtëpinë e saj edhe "Zejd Ibni Harithe" e që, mandej Hadixheja ja pat dorëzue atë H. Muhammedit i Cili e pat lëshuë dhe konsideruë si një njeri të lirë. Ai, e rriti dhe e edukoi dhe ma së fundi e bâni bir në shpirt! Kështu vazhdoi, gjersa Revelata Hyjnore e anuloi këtë adoptim mâ vonë.

I Dërguëmi i Zotit po derdhte të Gjithë mundin e Tij për me përhapë thirrjen dhe mësimet e Islamit. Përkrahëse mâ e madhe e kësaj thirrje dhe e këtyne mësimevet pat qenë e shoqja e Tij. H. Hadixheja. Meriton për t'u përmendë edhe xhaxhaj i Tij, Ebu Talibi, i cili i pat dhanë ndihmën mâ të madhe si edhe i pat kushtuë të gjithë mprojtjen e tij serioze, me gjithë se për besimin e tij ka dyshim dhe këtë pikë e zgjith vetëm kritika historike. Për të parën herë Profitin e patën besuë antarët e familjes si edhe disa nga fisi i Tij. Por, edhe ata nga fisi i Tij mâ i afërm që nuk e patën besuë, herën e parë, nuk e patën kundërshtuë. Atë, për veç këtyne që u-përmendën mâ sipër dhe disa të tjerë që e ndihmuën, e pat kundërshtuë shumica dërmonjëse (Majorité) e Kurejshëvet idhujtarë.

Në të X tin vit të Revelatës (Wahj), I dërguëmi i Zotit humbi Ebu Talibin, mprojtësin dhe xhaxhan e Tij të dashur. Vdekja e këtij e dëshpëroi shumë të Dërguëmin e Zotit. Por, ajo që e dëshpëroi mâ shumë ishte humbja e H. Hadixhesë. Hadixheja ndërroi jetë mbas Ebu Talibit. Humbja e këtyne dy personalitetevet ka ndodhë, të thuash, tre vjetë para Hexhirës.

I Dërguëmi i Zotit (Resulu-Llahi) si që e vërteton dhe e pohon edhe historiani i famshëm mysliman, Ebu-l-Feda, me të ndrruë jetë ata të dy, vûjti aqë shumë prej kundërshtimit t'adhuruësve t'idhujve, sa që jetesa e Tij në Mekke u-ba tepër e vështirë dhe plot me rreziqe. Një shumicë e madhe prej Kurejshit, e sidomos kryetarët e këtij Fisi patën gjetun lëmë për me e sulmuë të Dërguëmin e Zotit jo vetëm methodikisht por edhe drejt për drejt.

Zonja e madhe Hadixhe, si u-përmend edhe mâ naltë, ishte krahu i djathtë si edhe mprojtja mâ e madhe e të Dërguëmit të Zotit në të gjitha vështirësinat e jetës së Tij. Ajo i përngjan një Ministri a Këshlltari të math shteti, që ja kushtoi

të gjithë fuqinë mendore si edhe pasuninë e saj Islamit dhe Prisit të Math të njerzimit. Si që u-përmend ma nalt, Ajo ndërroi jetë të X tin Vit të Revelatës, tre vjet para Hexhirës që i takon vitit 619 M. Kr. Ky vit u-qujtë vit idhnimi dhe zije, sepse në këtë vit pat ndodhë dizastra dyfishe: Vdekja e xhaxhait të Profitit, Ebu Talibit, që e pat mprojtë aqë tepër prej sulmuësve arabë, si edhe ajo e bashkëshortes së Tij idealiste, që në shtëpinë të Cilës Profiti pat banuë. Hadixheja pat qenë një grue me të vërtetë inteligjente, idealiste, e urtë, e durëshme dhe një rregulluese e famëshme e shtëpisë dhe e familjes. Ajo pat qenë edhe një pjesëtare aktive në lëmin shoqënuër, aqë sa kujtimi i saj do të mbetet gjithëmonë i pa vdekshëm.

Ibni Saëdi, një tjetër Historian Mysliman i përmendur, pohon në librin e tij të Math *Tabakat*, vol. I Faqe 41; "Humbja e Hadixhes ju dhimb aq tepër të Dërguëmit të Zotit, a. s. sa që u-ligësh-tuë dhe qe frikë se mos t' i ndodhte ndonji gjë e pa pritun. «Kjo dhimbje dhe ky mjerim e pat ndaluë Atë që të mejtonte dhe kërkonte me u martuë rishtazi aq sa një ditë «Houle binti haqim» i drejtohet dhe i thotë: «O I Dërguëmi i Zotit besoj se humbja e Hadixhes të ka dëshpëruë për së tepri, a dishroni me u-martuë?» Po! Ajo ishte Nâna e Fëmijëvet, Edukuese e tyre dhe Mbretnesha e shtëpisë!», urdhëroi i Dërguëmi i Zotit.

SADIK BEGA



H. MUHAMMEDI DHE MISIONI I TIJ

NUK kam qellim këtu të raf problemat, që kanë ngatrrue menden e burrave e të grave të dijtshëm në çdo kohë. Unë do të mundohem të çfaqë përshtypjet e mija që më ka bërë besimi në Zotin e në misionin e atij, objekti i të cilit ishte me i çdukë supersticionet e me dëftue rrugën e vërtetë kjashtas.

Na rrojmë në një kohë me dyshime — dyshim për sa i përket çdo ngjarje e veprimi. Veprimi nga pikpamja shkencore del përfituese, se pse është burimi i përparimit modern në shkencë, e cila na ka dhënë radion dhe televizionin. Me gjithatë, a jemi na më pak të pa dijtshëm e të pakujdesshëm se stërgjyshit t'onë mbi problemat e jetës e të vdekjes ose të fillimit të botës?!

Ka njerës të këndueshëm, që nuk besojnë në Zotin, po ka edhe shkencëtarë që besojnë në 'Të. Lé t'a shoshitim këtë nga pikpamja shkencore. Ata që mjaftojnë me çka shohin e kuptojnë se, a janë më mendje gjënë se ata që ndërgjegjësisht apo me vetë-dije e përulin vehten para një fuqije që e ndijne të sundojë mbi 'ta? Ky ndryshim besimi difton padyshim se problemi i Përgjithjetshëm i Krijuesit s' është aq i kollajshëm për t'a kuptue si mendojnë disa; për ndryshe s' do kish dije-tarë të besonin në Zotin.

Njeriu gjithmonë ka besue mbi dishka përtej kësaj bote të dukëshme. Ai e ka ndië nevojën e t' Amshuemit qysh kur filloi të vijë ndër mend. Pasteur-i, gjeniu i math francez, n' adresimin e tij Akademis Franceze spjeron habitjen e njerzimit kur ai thotë: "Mendimi i pozitivizms¹⁾ harron idenë më të rëndësishme, atë t' Amshuemit. Ç' ka është përtej këtyne qiellnave me hyj? Nji qiell tjetër! Taman, e vërtetë është, atë-herë ç' ka është më përtej? A mundet imagjinata e jonë t'a kufizojë kohën e hapsinën!? Idea e Zotit është një formë kë-sodore e për sa kohë që të vazhdojë ky mister i të Pamba-

1) Pozitivizëm është një sistem filozofik, i themeluar prej Auguste Comte e që pretendon se nuk mund të njohim me të vërtetë, veçse vërtetsinat e konstatueme me ndërsnjetsinë e observacionit dhe t' eksperiencës.

rueshmit nër mendet e njerzve, faltore do të ngrihen për adhurimin e Tij: në se e thrasim Atë Zot ose Allah”.

Kështu pra Pasteur-i, sikur shumë shkencëtarë të tjerë, parashtron faktin se përtej botës së dukëshme ka Dishka, e cila na qarkon dhe sundon neve.

Këtu s’kam qëllim të hyj në detajet apo hollësitë. Në goftë se marrim parasysh historin e njerzimit q’është përpjek me zbulue burimin e kësaj Fuqije të Pakufishme, na gjejmë se sa më shumë përparon mendja njerzore, aqë më tepër shvillohet lidhja e çuditshme në konceptin (kuptimin) e kësaj Fuqije.

Në se njani krahason parimet e gjithë fenave—qysh prej kohnave të pa fillim e deri kur Muhammedi proklamoi misionin e tij, ka për të realizue se animi i gjithë besimeve s’është kurrëgjatë tjetër veçse shvillimi i spjegimit t’idesë së Zotit, e cila e përgatiti njerzimin, që një ditë të jetë i aftë të kuptojë iden e vërtetë. Kjo është që Islami i pranon e i njeh gjithë fenat e përparshme.

Nji ndër sendet më të çuditshme në historin e racës njerzore është fakti se një Jetimi a Bonjaku Arab, Bir’i shkretinës, iu zbulue rruga e dijes së vërtetë mbi Zotin.

Vlefëta e aktivitetit të Muhammedit s’mund të kuptohet pa pasë një njoftim të plotë të rrethanave t’asaj kohe — përçarjen e fiseve Arabe, supersticionet, barbarizmat, poshtërsit dhe urrejtjet e pa mëshirshme q’ata kishin kundrejt grave, etj.

Ai ishte njeriu që, në mes t’idolatërve, pa rrugën e drejtë për kë Zoti, të Zotit të Gjithësisë. A i detyrohesh kjo pra karakterit independent, gjenisë së tij apo ishte një inspiratë Hyjnore? Ai që pikërisht njeri si sikur të tjerët. Ai e shprehu qartas me fjalë të pandërlikueshme: “Jam si çdo njani nga ju, përjashtoj që jam i inspiruem” Kujtoj se çdo problem i math zbërthehet vetëm me anë t’inspiratës. Kështu pra, si e shifni, Islami s’është, si e kujtojnë miliona njerëz, Muhammedanizëm, me të cilën kanë qëllim adhurimin e Muhammedit, gjatë q’është në kundërshtim flagrant me mësimet e fesë Islame. Ai është njeri, e vetëm njeri i zgjedhun nga Zoti i Plotfuqishëm për me i udhëheqë njerzit e Tij; e këtu gjindet pika e rëndësishme që Islami bazohet mbi fakte njerzore.

Kjo duket pak a shumë e pa rëndësishme, por s’duhet të harrojmë se mëdhe edhe sot janë pak njerëz që mund t’a marrin vesht të vërtetën e kësaj deklarate të madhe.

Meqqja, në mes të tjerave, ishte qendra më e rëndësishme e idolatrisë, e njerzisë, si burrat e gratë, ishin ignorantë nga Zoti i Padukshëm i të gjithëve. Ata adhurojshin gjërat që bëjshin me dorë të vet, dhe s' ishte punë e lehtë me ua mësuë atyne udhën e drejtë që i çonte kë e vërteta. Muhammedi, a ishte zgjedhur për m'i mësuë e ndihmue vetëm popullit të vet apo pat dishka tjetër edhe për botën mbarë? Mendimi i tij mund të shtrihesh përtej kufive të vend-lindjes së vet: Ai pat dishka për gjithë kohat e për të tashmë popujt.

Mësimet e tija nuk ishin të kufizueme as në pikpamje vendesh as komunitetesh: deklarata e tij që një revelatë që pruni revolucionin e ideve të miliona popujve të çdo kohe e klime. Islami iu dha material për t'u mendue filozofëve që e studjuen atë në shumë krahina të ndryshme, prej Spanje në Çinë e deri në Filipinë. Disa shkrimtarë t' anshëm janë përpjekun të dëftojnë se i detyrohesh pushtimit Arab që Islami u përhap. Kurrëgjatë s' do t' ishte më larg së vërtetës se sa një thënie e tillë. Islami në vet-vehte e ka fuqinë pushtuese. Ay i çeli sytë kombeve që patën adhurue veprat bënë prej dorës së tyre: ata (arabët) s' kishin ndonjë ide para, që ka Dishka më të fuqishme, më të rëndësishme, të pafund e supreme.

REDAKTORI

(Vijon)

Posta e Jonë

H. K. Durrës — Qëllimi i asaj çka shkrueshit përmblihet në artikullin «Përball së Vërtetës», botue në këtë numur.

R. A. Tiranë — Mbi sa pyetshit pasoni artikullin shkruar prej Drejtorit.

E. F. K. Kairo — Për sa na dërgojshit, ju falemi nderit, do t'i studjojmë.

J. H. Tepelenë — Artikulli që i drejtojsht ish Revistës «Zani i Nanltë», na ra në dorë; për shkak mos-qartsije dhe gabimesh orthografike, nuk mund të botohet.

M. C. Delvinë. — Të hollat fr. ari 4 për pajtimin e ish Revistës «Zani i naltë, i-u dorëzuën Arkës. Revista e Ré po ju dërgohet.

H. S. Tiranë. — Urime për fitimin ndër mësimet e nalta Theologjike Islame.

A. A. Caserta (Itali). — Si mbas dëshirës do ja u çojmë Revistën si një abonist i rregullt.

P. T. «Gazeta Shqiptare» Bari — Ju falemi nderit për dërgimin e Fletores. Lutemi korrigjoni adresën t'onë nga «Jeta di Kultura» në «Kultura Islame».

P. T. Gazetës «7 Prill». Gjinokastër — Ju falemi nderit për dërgimin e Fletores.

L A J M Ë R I M

Pajtimtarët që dëshirojnë të jenë në rregull me këtë Revistë, duhet t'i drejtohen kësaj Administrate me letra.

SHTYPUN NË SHTYP. «SHKODRA» — TIRANË